



COLGATE-PALMOLIVE COMPANY

# *Kodi i Sjelljes*

Të jetojmë vlerat tona

# NE

FUQIA JONË

## Mesazh nga Kryetari, Presidenti dhe Drejtori i Përgjithshëm

Kodi ynë i Sjelljes ka udhëhequr punonjësit e Colgate për mbi 30 vite me parimet që pasqyrojnë vlerat tona dhe standardet e vendosura të sjelljes etike. Ndërsa vlerat dhe parimet tona janë të qëndrueshme, Kodi përditësohet herë pas here për të qenë në harmoni me kontekstin e biznesit tonë që është përherë në ndryshim. Puna jonë si Punonjës të Colgate, pavarësisht se në ç'pjesë të botës punojmë, është të sigurohemi që sjellja dhe vendimet tona t'i përmbahen gjithnjë Kodit.

Ky vit solli sfida dhe mundësi të reja që ndikuan në të gjitha aspektet e jetës sonë, duke përfshirë mënyrat se si ne punojmë. Puna në distancë do të vazhdojë të jetë një element i rëndësishëm i mënyrës se si punojmë. Por nuk mund të lejojmë që distanca të ndikojë në angazhimin tonë të përbashkët ndaj sjelljes etike. Punonjësit e Colgate pritet që ta lexojnë, ta kuptojnë dhe të veprojnë në pajtueshmëri të plotë me Kodin. Nga ju pritet gjithashtu që të “shprehni hapur mendimin” dhe të kundërshtoni sjelljet që bien ndesh me Kodin tonë, me politikën tona apo me ligjet në fuqi. Këto angazhime garantojnë që të gjitha vendimet tona në punë — apo vendimet tona personale që ndikojnë në punë — të udhëhiqen nga përgjegjësia jonë për të vepruar me integritet dhe bazuar në standardet më të larta etike.

Punonjësit e Colgate dëshirojnë të fitojnë për shkak se qëllimi ynë është shumë i rëndësishëm: ne po rikonceptojmë një të ardhme më të shëndetshme për të gjithë njerëzit, kafshët e tyre shtëpiake dhe planetin tonë. Ne krenohemi shumë me rezultatet e biznesit, si dhe me mënyrën se si i arrijmë ato rezultate. Duke qenë një kompani globale që operon në një treg tejet konkurrues, presioni ndaj biznesit është i pritshëm. Megjithatë, zgjedhja e rrugës së shkurtër apo shkelja e Kodit të Sjelljes nuk është asnjëherë e justifikueshme.

Faleminderit paraprakisht për përkrahjen e vlerave tona dhe për angazhimin në çuarjen përpara të qëllimit tonë me standardet etike më të larta, të cilat janë tejet jetike për suksesin e vazhdueshëm të biznesit tonë.



Noel Wallace  
Kryetari, Presidenti dhe  
Drejtori i Përgjithshëm

***“Suksesi ynë gjendet në aftësinë tonë për të mbajtur standardet më të larta etike duke vepruar në mënyrën e duhur.”***

## **Pasqyra e lëndës**

<i>Rreth Kodit të Sjelljes</i>	4
<i>Çelësat e vendimmarrjes etike</i>	5
<i>Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit</i>	6

<i>Qëllimi dhe vlerat tona</i>	7
<i>Përgjegjësia jonë për Kodin e Sjelljes</i>	9

### **MARRËDHËNIET TONA**

<i>Marrëdhënia me njëri-tjetrin</i>	11
<i>Marrëdhënia me kompaninë</i>	14
<i>Marrëdhënia me subjektet jashtë kompanisë</i>	25
<i>Marrëdhënia me konsumatorët</i>	28
<i>Marrëdhënia me ligjin</i>	31
<i>Marrëdhënia me shoqërinë</i>	39
<i>Marrëdhënia me mjedisin</i>	42
<i>Marrëdhënia me aksionarët tanë</i>	44

### **SHPREHJA HAPUR E MENDIMIT**

<i>Përgjegjësia jonë për të shprehur hapur mendimin</i>	46
---	----

# Rreth Kodit të Sjelljes

Kodi ynë i Sjelljes shërben si një burim i rëndësishëm për të garantuar që veprimet tona të përditshme të biznesit të kryhen me integritet. Kodi i shpjegon qartë secilit prej nesh se mënyra se si i arrijmë rezultatet në punë ka rëndësi. Kodi zbatohet për të gjithë punonjësit e Colgate, duke përfshirë drejtorët, menaxherët dhe të gjithë punonjësit e kompanisë dhe filialeve të saj. Edhe furnizuesit dhe furnitorët u nënshtrohen këtyre kërkesave, sepse zbatimi i Kodit të Sjelljes për Palët e Treta të Colgate është kusht për të punuar me Colgate.

Çdo punonjës ka përgjegjësinë të veprojë në përputhje me Kodin, Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit, politikat e kompanisë dhe të gjitha ligjet e zbatueshme. Duke përfshirë në mënyrë të plotë etikën dhe ndershmërinë në vendimmarrjen dhe marrëdhëniet e vazhdueshme të biznesit tonë, ne demonstrojmë përkushtimin ndaj një kulture që nxit standardet më të larta etike.


Colgate është e përkushtuar të krijojë një mjedis pune pa sjellje të papërshtatshme ose të paligjshme, ku njerëzit inkurajohen

të ndajnë shqetësimet e tyre me kompaninë, pa pasur frikën e hakmarrjes ndaj tyre. Në Colgate, nuk do të ndërmerret asnjë veprim i padëshirueshëm kundër ndonjë punonjësi, ish-punonjësi, agjenti ose pale të tretë, për shkak se është ankuar, ka raportuar, ka marrë pjesë apo ka ndihmuar në hetimin e një shkeljeje të dyshuar të Kodit të Sjelljes të kompanisë, politikës së kompanisë ose ligjit të zbatueshëm, përveç rasteve kur zbulohet se akuza e bërë ose informacioni i dhënë është falsifikuar me qëllim ose nuk është krijuar ose dhënë në mirëbesim. Colgate do të ruajë konfidencialitetin e të gjitha ankesave në masën maksimale të mundshme. Të gjitha akuzat për hakmarrje do të hetohen dhe, nëse shihet me vend, do të ndërmerret veprim disiplinor deri në, dhe duke përfshirë, heqjen nga puna.

Kodi është në dispozicion në internet dhe është përkthyer në dyzet e dy gjuhë. Punonjësve të Colgate u kërkohet që ta lexojnë, ta kuptojnë dhe ta zbatojnë Kodin. Për të përforcuar angazhimin tonë, punonjësit e Colgate vazhdimisht kryejnë trajnime dhe marrin certifikata për pajtueshmërinë me Kodin mbi baza vjetore.

# Çelësat e vendimmarrjes etike

Pajtueshmëria me Kodin mund të sigurohet më me lehtësi duke përdorur gjykim të shëndoshë dhe duke kërkuar këshilla kur lindin pyetje. Në rast se nuk jeni i sigurt për një veprim të caktuar, bëjini vetes pyetjet e mëposhtme:



Në qoftë se keni pyetje ose shqetësime në lidhje me interpretimin ose pajtueshmërinë me Kodin, Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit ose me ndonjë procedurë apo politikë që ka të bëjë me Colgate, këtë situatë duhet ta diskutoni me menaxherin tuaj, Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources), Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization), ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance).




# *Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit*

Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit (BPG) i Colgate është një burim për punonjësit, i hartuar për të ofruar orientim të mëtejshëm dhe më të detajuar mbi udhëzimet, standardet, politikat dhe praktikat përkatëse të kompanisë. Udhëzuesi BPG zbatohet për të gjithë punonjësit e Colgate, duke përfshirë drejtorët, menaxherët dhe të gjithë punonjësit e kompanisë dhe filialeve të saj.

Nëse keni pyetje ose dyshime lidhur me ndonjë aspekt të BPG, apo ndonjë politikë apo ligj tjetër të zbatueshëm që lidhet me të, duhet të komunikoni me Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization), Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance), Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources) ose menaxherin tuaj.

Për të mësuar më tepër, punonjësit e Colgate mund të hyjnë te **Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit këtu**.



# ***Qëllimi dhe vlerat tona***

# Arkitektura e kulturës së Colgate

## QËLLIMI: Përse ekzistojmë

Ne jemi Colgate, një kompani që tregon kujdes, me një rritje novatore, e cila po rikoncepton një të ardhme më të shëndetshme për të gjithë njerëzit, kafshët e tyre shtëpiake dhe planetin tonë.

## VLERAT: Kush jemi

### Ne jemi dashamirës

Ne jemi të bashkuar për ta bërë botën një vend më të mirë

### Ne jemi gjithëpërfshirës

Ne krijojmë një ndjenjë përkatësie për të gjithë

### Ne jemi të guximshëm

Ne nxisim ndryshimin dhe jemi të suksesshëm në atë që bëjmë

## PARIMET E UDHËHEQJES: Si udhëheqim

### Kultivojmë besimin

Dëgjojmë me mirëkuptim  
Shprehim hapur mendimin  
Rritemi së bashku

### Krijojmë të ardhmen

Eksplorojmë kureshtjen  
Ndryshojmë me kurajë  
Dallojmë progresin

### Përkushtohemi ndaj ndikimit

Ofrojmë qartësi  
Mbajmë përgjegjësi  
Bëjmë atë është e drejtë

## F.E.E.D.: Si punojmë

### Të fokusuar

në prioritetet tona strategjike

### Të fuqizuar

dhe me ekipe të përgjegjshme

### Në mënyrë eksperimentale

për të përshpejtuar novacionin dhe të mësuarit

### Në mënyrë dixhitale

të lidhur dhe bazuar në të dhëna



# *Përgjegjësia jonë për Kodin e Sjelljes*



## **Roli i të gjithë punonjësve të Colgate:**


- ✓ Demonstrimi i vlerave të Colgate
- ✓ Ruajtja e standardeve më të larta etike dhe demonstrimi i udhëheqjes etike.
- ✓ Njohja dhe respektimi i politikave të Colgate, Udhëzuesit të Praktikave të Biznesit dhe Kodit të sjelljes.
- ✓ Përgjegjshmëria personale dhe e kolegëve për sjellje etike. Kundërshtimi i sjelljes që bie ndesh me politikat ose Kodin e sjelljes të Colgate.
- ✓ Mosmarrja hak ndaj kolegëve që shprehin hapur mendimin për një problem apo shqetësim.
- ✓ Nëse jeni të pasigurt, bëni pyetje dhe këshillohuni me menaxherin tuaj, Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources), Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë (Ethics and Compliance).



## **Roli i menaxherëve të punonjësve të Colgate:**

Ne presim që menaxherët e punonjësve të Colgate të udhëheqin me përgjegjësi duke u bërë shembull dhe duke shfaqur vendimmarrje të shëndoshë. Përgjegjësitë tuaja si menaxherët e punonjësve të Colgate përfshijnë:

- ✓ Dhënia e shembullit të drejtë duke vepruar me integritet, duke trajtuar të tjerët me respekt dhe duke shërbyer si model i standardeve më të larta etike.
- ✓ Ritheksimi i rëndësisë së vlerave etike dhe angazhimit të kompanisë ndaj sjelljes etike.
- ✓ Mbajtja e politikës së “dyerve të hapura”.
- ✓ Krijimi i një mjedisi pozitiv pune ku ekipi juaj ndihet komod të vijë tek ju për të ngritur shqetësime, për të kërkuar këshilla ose për të raportuar sjellje të pahijshme të dyshuara.
- ✓ Rikonfirmimi i politikës kundër hakmarrjes të kompanisë.
- ✓ Nëse jeni të pasigurt, konsultohuni me menaxherin tuaj, Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources), Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë (Ethics and Compliance).



# *Marrëdhënia me njëri- tjetrin*



## **Ne përpiqemi që të kemi marrëdhënie të suksesshme pune**

Ne ndërtojmë marrëdhënie të suksesshme dhe afatgjata duke demonstruar vlerat e kompanisë dhe duke ruajtur një kulturë respekti.

Në Colgate ne krenohemi me angazhimin e fortë personal të punonjësve tanë. Ky nivel përkushtimi mund të arrihet vetëm në një klimë besimi, komunikimi të sqartë e të hapur dhe respekti. Të gjitha veprimet tuaja me kolegët, vartësit e drejtpërdrejtë dhe eprorët duhet të kryhen si partneritet, në të cilin sjellja e çdo individit udhëhiqet nga përkushtimi parësor ndaj vlerave tona dhe për të ruajtur standardet më të larta etike.

Ne gëzojmë një forcë pune që reflekton diversitetin e botës të cilës i shërbejmë. Ne i pranojmë pikat e forta dhe talentet e shumta që forca jonë e larmishme e punës sjell në organizatë. Kjo nënkupton pranimin e këndvështrimeve të tjera dhe respektimin e kulturave, mendimeve ose mënyrave të jetesës që mund të ndryshojnë nga e jona.

Marrëdhënia juaj me ata me të cilët punoni duhet të promovojë sjelljen etike duke vendosur një shembull të mirësjelljes, drejtësisë dhe integritetit. Si udhëheqës, ne të gjithë kemi përgjegjësinë që të ruajmë standarde të larta për kryerjen e punës dhe të krijojmë një mjedis që nxit punën në grup, një mjedis pune të respektueshëm dhe sjelljen etike.



## **Ne i vlerësojmë punonjësit e Colgate**

Përkushtimi i Colgate ndaj punonjësve tanë demonstron nëpërmjet llojeve të ndryshme të programeve të përgatitura për nxitjen dhe shpërblimin e arritjeve individuale dhe të grupeve të punës. Ju inkurajoheni të arrini potencialin tuaj të plotë dhe të jepni një kontribut kuptimplotë për suksesin e kompanisë. Në fund, është fuqia jonë ajo që mundëson suksesin e kompanisë sonë.

### ***Kompania Colgate-Palmolive ndalon diskriminimin ndaj çdo punonjësi apo kandidati për punonjës për shkak të:***

- ✓ Racës ose etnisë
- ✓ Ngjyrës
- ✓ Fesë
- ✓ Gjinisë ose identitetit gjinor
- ✓ Origjinës kombëtare
- ✓ Nënshitetësisë
- ✓ Moshës
- ✓ Shtatzënisë
- ✓ Orientimit seksual
- ✓ Aftësisë së kufizuar
- ✓ Statusit të veteranit
- ✓ Gjendjes civile apo statusit familjar
- ✓ Statusit si një viktimë e dhunës në familje
- ✓ Ndonjë tipari tjetër të mbrojtur me ligj

Kjo përfshin, por nuk kufizohet në rekrutimin, marrjen në punë, ngritjen në përgjegjësi, transferimin, kompensimin, trajnimin, uljen në përgjegjësi ose shkurtimet.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar **Mundësive të Barabarta të Punësimit në Kompani dhe Politikës kundër Ngacmimeve** në [ourcolgate.com](http://ourcolgate.com).

Vlera e përfshirjes pasqyrohet në kulturën, praktikat dhe respektin e kompanisë sonë në politikat për vendin e punës. Ne mbajmë një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe arrijmë përsosmërinë duke tërhequr dhe mbajtur njerëz nga të gjitha shtresat në forcat tona të punës. Kompania jonë e vlerëson diversitetin dhe ne jemi të përkushtuar ndaj një mjedisi pune ku punonjësit trajtohen me ndershmëri

dhe barazi si nga drejtuesit, ashtu edhe nga kolegët dhe nxiten t'i shprehin idetë dhe mendimet e tyre. Ne presim nga të gjithë punonjësit tanë që t'i qëndrojnë angazhimit tonë ndaj një kulture ku sjellja me respekt është norma. Mësoni më shumë rreth iniciativave tona për diversitetin duke iu referuar **Raportit të Kompanisë për Diversitetin, Barazinë dhe Përfshirjen**.

- ✓ Ne ndalojmë ngacmimet seksuale apo çdo lloj tjetër ngacmimi ndaj punonjësve të Colgate ose palëve të treta që bëjnë biznes me Colgate nga ndonjë person në vendin e punës apo gjatë zhvillimit të punës së kompanisë, në përputhje me ligjin në fuqi.
- ✓ Ne ndalojmë favorizimin apo shfaqjen e favorizimit në vendin e punës, në përputhje me politikat dhe procedurat e Kompanisë.
- ✓ Ne nuk e përdorim punën e fëmijëve. Punë e fëmijëve konsiderohet punësimi i kujtdo personi që është nën moshën minimale që lejohet me ligj në juridiksionin në fjalë. Megjithatë, ne në asnjë mënyrë nuk do të punësojmë, me dashje, askënd nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç.
- ✓ Ne përpiqemi që të eliminojmë rreziqet e mundshme në vendin e punës dhe të veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet dhe standardet përkatëse shëndetësore dhe të sigurisë profesionale.
- ✓ Ne ndalojmë mbajtjen, përdorimin, shitjen apo transferimin e drogave të paligjshme apo pajisjeve të konsumimit të drogës dhe keqpërdorimin e mjekimeve me receta në ambientet e kompanisë (duke

përfshirë dhe makinat) apo në kohën që jeni në kompani;

- ✓ Ne ndalojmë kryerjen e punës së kompanisë ndërsa jeni nën ndikimin e alkoolit apo drogave të tjera.
- ✓ Ne kërkojmë që çdo rast abuzimi me drogë ose alkool në vendin e punës, rast dhune ose mbajtjeje të paligjshme armësh në mjedisin e kompanisë ose gjatë orarit të punës, t'i raportohet menjëherë Zyrës së Burimeve Njerëzore (Human Resources), Zyrës së Sigurisë Globale (Global Security), Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization), Departamentit të Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance) ose drejtuesve.
- ✓ Ne ndalojmë mbajtjen ose përdorimin e armëve të ftohta/armëve të zjarrit, pajisjeve shpërthyesë ose municionit në mjediset e kompanisë ose gjatë kryerjes së biznesit të Colgate, në përputhje me ligjet lokale. Mbajtja e armës mund të autorizohet për personelin e sigurisë, kur përcaktohet se mbajtja e saj është e nevojshme për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e Colgate dhe të punonjësve të saj.
- ✓ Ne ndalojmë çdo veprim që mund të perceptohet si i dhunshëm, kërcënues, degradues, frikësues apo që mund t'i shkaktojë personit tjetër një gjendje pasigurie.


Nëse keni ndonjë shqetësim për kërcënime apo veprime dhune që ndikojnë në mjedisin e punës, kontaktoni menjëherë Zyrën e Sigurisë Globale (Global Security) në +1 212-310-3333.





***Marrëdhënia  
me  
kompaninë***

Ne bëhemi më të fortë duke vepruar me integritet dhe ndershmëri në të gjitha situatat në të cilat jemi të angazhuar në emër të kompanisë.



## **Ne shmangim konfliktet e interesit**

Gjykimi juaj është një nga gjërat tuaja më të vlefshme. Duhet të shmangni çdo veprimtari apo shoqëri që bie ndesh apo duket se komprometon objektivitetin tuaj apo përdorimin e gjykimit të pavarur në kryerjen e punës për apo me Kompaninë. Konfliktet mund të lindin në shumë situata. Është e pamundur që t'i shqyrtojmë të gjitha ato këtu dhe nuk do të jetë gjithmonë e lehtë për të bërë dallimin midis aktivitetit të duhur dhe atij të pavend. Kur të keni dyshime, këshillohuni me menaxherin tuaj, Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources), Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance) përpara se të ndërmerri ndonjë veprim.



## **Investimet**

Mos bëni asnjë investim që mund të ndikojë në vendimet tuaja në punë. Politikat e Kompanisë i ndalojnë punonjësit e Colgate që të zotërojnë vlera të larta të aksioneve apo të kenë interes pronësor në një kompani që konkurren apo që bën biznes me Colgate. Ky moslejim nuk ka të bëjë me zotërimin e sasive të vogla (në përgjithësi nën 1%) të aksioneve të një kompanie që tregtohet publikisht, me kusht që investimi të mos jetë aq i madh financiarisht sa që të krijojë përshtypjen e konfliktit të interesit. Nëse keni kryer investime potencialisht të ndaluara përpara se të bashkoheni me Colgate, ju lutemi të kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal

Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance).



## **Familja**

Mund të gjendeni në një situatë ku bashkëshorti/ja juaj apo një anëtar i afërm i familjes është (ose është punësuar pranë) një prej konkurrentëve, klientëve apo furnitorëve të Colgate. Këto situata nuk janë të ndaluara, por kërkojnë një ndjeshmëri më të lartë për të trajtuar shqetësimet e mundshme sa i përket sigurisë, konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit. Kjo situatë, sado e padëmshme mund t'ju duket, mund të shkaktojë shqetësim te kolegët tuaj, gjë që mund të ndikojë në marrëdhëniet tuaja në punë. Qoftë dhe vetëm shfaqja e një situatë të konfliktit të interesit mund të krijojë probleme, pavarësisht sjelljes tuaj të përshtatshme.

Për të shmangur këto probleme, duhet të rishikoni situatën tuaj specifike me menaxherin tuaj, Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance) në mënyrë që të vlerësoni natyrën dhe shtrirjen e çdo shqetësimi dhe në mënyrë që të përcaktoni zgjidhjen e duhur.



## **Puna tjetër**

Ndërsa punojnë për Colgate, punonjësit e Colgate nuk mund të punojnë apo të ndihmojnë një konkurrent apo ndonjë palë të tretë që bën biznes me Colgate. Gjithashtu, mos përdorni orarin, ndërtesat, burimet, markat ose logot e Kompanisë për punë të jashtme që nuk lidhen me punën tuaj në Colgate, pa autorizim nga shefi i Seksionit apo Funkcionit tuaj.



## Personale

Colgate njeh dhe respekton të drejtat e punonjësve të saj që të shoqërohen lirisht me çdokënd që hasin në ambientin e punës. Megjithatë, marrëdhëniet personale mund të krijojnë konflikt interesi dhe ne duhet të përdorim gjykim të shëndoshë për të siguruar që këto marrëdhënie:

- Të mos ndikojnë negativisht në rendimentin në punë
- Të mos pengojnë aftësinë për të mbikëqyrur të tjerët
- Të mos përçajjnë ambientin e punës
- Të mos krijojnë përshtypjen e favorizimit

Çdo sjellje në punë, që rezulton nga një marrëdhënie romantike ose miqësore midis punonjësve, mund të jetë e papërshtatshme në qoftë se krijon një mjedis jo të rehatshëm pune për të tjerët ose mendimin se mund të ketë trajtim të favorshëm. Ndalohen favorizimet ose marrja e vendimeve në punë duke u bazuar në marrëdhënie romantike ose miqësore dhe jo në interesin më të mirë të kompanisë.

Përveç kësaj, nuk është e përshtatshme që një epror ose kushdo në një pozicion drejtues të përfshihet në një marrëdhënie romantike me një vartës. Marrëdhëniet romantike me vartësit mund të zvogëlojnë aftësinë tuaj për të qenë objektivë për çështje si kompensimi, ngritjet në detyrë, detyrat e punës, caktimet e turneve, mundësitë e punës jashtë orarit ose trajnimit. Në këtë situatë, të dy punonjësit duhet ta raportojnë situatën te Zyra e Burimeve Njerëzore (Human

Resources) ose Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance). Nëse jeni në dijeni të një marrëdhënieje romantike që mund të konsiderohet konflikt, këshillohuni me Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance).



## Bordet

Ju lutemi merrni më parë miratimin e Shefit të Etikës dhe Pajtueshmërisë dhe Shefit të Zyrës Ligjore përpara se të bini dakord për të shërbyer në një Bord Drejtorësh apo një organ të ngjashëm në një kompani fitimprurëse apo institucion shtetëror.

Nuk ju duhet miratim për të shërbyer në Bordin e një organizate jofitimprurëse, përveç rasteve kur organizata ka një marrëdhënie profesionale apo pune me kompaninë, rast në të cilin kërkohet miratimi nga shefi apo përgjegjësi i departamentit tuaj.

Nëse keni pyetje apo gjendeni në një situatë potenciale konflikti interesi, këshillohuni me menaxherin tuaj, Zyrën e Burimeve Njerëzore (Human Resources), Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance). Kompania do të punojë me ju për të shqyrtuar situatën dhe për të identifikuar një zgjidhje të përshtatshme.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi konfliktin e interesit dhe dhuratat, që mund të gjenden te **Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit**.



## **Ne e mbrojmë informacionin e rezervuar të kompanisë**

Informacioni i rezervuar i Colgate është një aset i vyer. Informacioni i rezervuar, është ai informacion që përdoret në lidhje me biznesin e Colgate, që nuk është i njohur gjerësisht apo që nuk është lehtësisht i zbulueshëm dhe që duhet të mbahet i fshehtë nga konkurrenca. Mbrojtja e informacionit të rezervuar luan një rol jetësor në rritjen tonë të vazhdueshme dhe na jep mundësinë për të konkurruar.

## **Cilat janë disa prej shembujve të informacionit të rezervuar?**

Edhe pse e paplotë, kjo listë jep shembuj të shumëllojshmërisë së informacionit që duhet ruajtur.

- ✓ Objektivat apo strategjitë e biznesit
- ✓ Listat e punonjësve, klientëve, konsumatorëve, specialistëve apo shitësve
- ✓ Aplikimet për patenta
- ✓ Informacioni financiar jopublik
- ✓ Formulatat e produkteve
- ✓ Proceset e prodhimit
- ✓ Çdo lloj materialesh të papublikuara marketingu ose shitjesh
- ✓ Informacione të brendshme të cilat nuk janë bërë publike

## **Detyrimet tuaja sa i përket informacionit të rezervuar të Colgate janë:**

### **VEPRIMET E DUHURA**

- ✓ Merrni masa të arsyeshme për të mbrojtur informacionin e rezervuar të Colgate.
- ✓ Vendosini dokumenteve të rezervuara shënimin "Konfidencial" apo "I rezervuar".
- ✓ Jini të kujdesshëm kur diskutoni informacionin konfidencial në ashensor, hapësira të përbashkëta apo në vende të tjera publike.

### **VEPRIMET E GABUARA**

- ✓ Dhënia e informacionit të rezervuar punonjësve të tjerë të Colgate ose palëve të treta përveçse kur "duhet ta dinë" ose "duhet ta përdorin".
- ✓ Angazhimi i palëve të treta që të trajtojnë informacionin e rezervuar, pa miratimin e duhur dhe pa një marrëveshje konfidencialiteti të përcaktuar.
- ✓ Publikimi apo diskutimi i informacionit të rezervuar në faqe interneti në dispozicion të publikut ose në faqe të mediave sociale.
- ✓ Përdorimi i informacionit të rezervuar për përfitim tuajin ose përfitimin e paautorizuar të personave jashtë Colgate.
- ✓ Lënia e informacionit të rezervuar në dhoma konferencash apo në zyra të pambyllura.

Nëse largoheni nga Colgate, vazhdoni të keni detyrimin për të mbrojtur informacionin e rezervuar të Colgate. Duhet të keni gjithashtu parasysh se korrespondencat, materialet e printuara, informacioni elektronik, dokumentet apo regjistrimet e çdo lloji, njohuritë specifike të procesit dhe procedurave - qofshin konfidenciale ose jo - janë të gjitha pronë e kompanisë dhe duhet të mbeten në Colgate. Nëse largoheni nga kompania, duhet të riktheni të gjitha sendet në pronësi të kompanisë që posedoni, keni në kujdestari apo nën kontroll. Nëse keni ndonjë pyetje nëse informacioni është i rezervuar ose jo, duhet të kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë për mbrojtjen e informacionit të rezervuar, që mund të gjenden tek **Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit**.



## **Ne u përmbahemi politikave të kërkesave nga shtypi dhe media**

Punonjësit e Colgate nuk duhet t'i kthejnë përgjigje asnjë kërkesë apo publikimi të medias, shtypit, komunitetit financiar apo publikut, që u kërkon të flasim në emër të Colgate.

- Kërkesat për intervista apo pyetje nga media, shtypi, komuniteti financiar apo publiku i duhen referuar Departamentit për Komunikimet e Korporatës (Corporate Communications) ose Departamentit të Marrëdhënieve me Investitorin (Investor Relations).

- Kërkesat për t'i dhënë informacion në emër të Colgate kontakteve nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe i Shkëmbimeve, Bursa e Nju-Jorkut, të tjera institucione rregullatore apo përfaqësues të jashtëm ligjorë, i duhen referuar menjëherë Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Është e rëndësishme që asnjë punonjës të mos u përgjigjet në emër të kompanisë ose në emër të vet kërkesave ose kontakteve të tilla, sepse çdo përgjigje e papërshtatshme ose e pasaktë, qoftë kjo edhe një mohim ose mospranim informacioni, mund të çojë në publicitet negativ, rrezik ligjor ose ndikim serioz për kompaninë. Kjo përfshin edhe hetimet ose angazhimet në media sociale.

Kjo politikë nuk përfshin kërkesat për informacionin financiar në dispozicion të publikut, të tilla si raportet vjetore dhe tremujore ose aktivitetet promovuese publike të kompanisë.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë për tregtinë e letrave me vlerë dhe zbulimin e informacionit, që mund të gjenden tek **Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit**.



## Ne mbajmë regjistra dhe dokumentacion të saktë

Pozicioni financiar i kompanisë sonë dhe rezultatet e operacioneve të saj duhen dokumentuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe parimet e kontabilitetit të pranuar nga të gjithë (GAAP). Colgate ka detyrimin të mbajë regjistra, libra dhe llogari financiare që pasqyrojnë në mënyrë të saktë dhe të drejtë transaksionet dhe asetet e Kompanisë e gjithashtu të mbajë një sistem të përshtatshëm të kontrolleve të brendshme të llogarive.

Kushdo që përfshihet në krijimin, përpunimin dhe regjistrimin e informacionit financiar është përgjegjës për integritetin e tij dhe:

- Duhet të marrë lejet e nevojshme dhe të sigurohet që të gjitha transaksionet dhe shpenzimet të jenë të regjistruara si duhet në librat dhe regjistrat e kompanisë, duke përfshirë vlerën e shpenzimit, përfituesin apo marrësin e vlerës dhe qëllimin për të cilin është kryer ky shpenzim.
- Duhet të japë informacion të plotë dhe të saktë dhe dokumentacionin e duhur lidhur me të gjitha transaksionet e kompanisë dhe natyrën e aseteve.
- Duhet të sigurohet që çdo transaksion, llogari apo e dhënë financiare të pasqyrojë në mënyrë të përpiktë atë që përshkruhet në dokumentet shoqëruese. Nuk duhet të ketë fshehje të informacionit ndaj ose prej drejtuesve të lartë ose ndaj revizorëve të brendshëm të kompanisë ose atyre të pavarur.

- Për asnjë arsye, nuk duhen regjistruar të dhëna false apo të gabuara në librat dhe regjistrat financiarë të kompanisë.
- Nuk duhet të përdorë një pagesë për asnjë qëllim tjetër nga ai i përshkruar nga dokumentet që mbështesin pagesën.
- Nuk duhet të përdorë fondet apo asetet e kompanisë për asnjë qëllim të paligjshëm ose të papërshtatshëm.
- Duhet të pasqyrojë siç duhet dhe në kohë të ardhurat dhe shpenzimet.

Aktivitetet dhe pasivitetet duhen regjistruar dhe vlerësuar në mënyrën e duhur. Përveç kësaj, ata që janë përgjegjës ose që janë të përfshirë në përgatitjen e dokumenteve të Colgate pranë Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Shkëmbimeve dhe të dokumenteve të tjera që i kërkon ligji përkatës ose të komunikimeve të tjera me komunitetin financiar ose të biznesit, duhet të sigurohen që deklaratimet në këto dokumente dhe komunikime të jenë të plota, të sakta, të ligjshme, në kohë dhe të kuptueshme.

Në qoftë se hasni ndonjë mungesë, falsifikim ose pasaktësi të mundshme në regjistrimet financiare ose të kontabilitetit ose në raportet e Colgate për Komisionin e Letrave me Vlerë dhe Shkëmbimeve ose në komunikime të tjera ose ndonjë anomali në kontrollet e brendshme, duhet që këtë informacion t'ia raportoni menjëherë menaxherit tuaj ose Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization). Ju mund të kontaktoni gjithashtu Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance).

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë për librat, regjistrat dhe dokumentet, të cilat mund të gjenden në **Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit**.

## **Mbani mend**

- ✓ Librat dhe regjistrat e kompanisë duhet të jenë të sakta
- ✓ Dokumentet e kompanisë duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme
- ✓ Për asnjë arsye nuk duhen regjistruar të dhëna false apo të gabuara

## **Ne mbrojmë asetet e Colgate**

Asetet, ndërtesat ose shërbimet e kompanisë duhen përdorur vetëm për qëllime të ligjshme, të duhura dhe të autorizuara. Vjedhja e parave, pronës dhe shërbimeve ndalohet rreptësisht. Përdorimi i pajisjeve, sistemeve, ndërtesave, kartave të kreditit të korporatës dhe artikujve të korporatës së Colgate duhen përdorur vetëm në lidhje me punën tuaj te Colgate ose për qëllime të autorizuara nga

drejtuesit. Ju keni përgjegjësi personale jo vetëm për mbrojtjen e pronës që ju është besuar nga kompania, por edhe për të ndihmuar në mbrojtjen e asetëve të kompanisë në përgjithësi. Duhet të jeni vigjilentë ndaj çdo situatë ose incidenti që mund të çojë në humbjen, keqpërdorimin ose vjedhjen e pronës së kompanisë dhe të gjitha situatat e tilla duhet t'ia raportoni menaxherit tuaj ose Zyrës së Sigurisë Globale (Global Security), sapo të viheni në dijeni të tyre.

Vetëm zyrtarë të caktuar dhe punonjës të tjerë të lartë të kompanisë janë të autorizuar të bëjnë premtime që kanë të bëjnë me asetet e kompanisë. Përveçse kur autorizoheni siç duhet, nuk duhet të bëni premtime që kanë të bëjnë me asetet e kompanisë.

Nëse keni pyetje ose ju nevojitet sqarim, duhet të kontaktoni zëvendësdrejtorin financiar lokal ose të departamentit tuaj.



## **Ne e përdorim në mënyrë të përgjegjshme teknologjinë e informacionit, inteligjencën artificiale dhe mediat sociale**

### **Përdorimi i Burimeve TI**

Burimet e Teknologjisë së Informacionit (TI) të Colgate duhet të përdoren me përgjegjësi dhe në përputhje me Kodin dhe me politikat dhe procedurat e tjera të Kompanisë. Burimet TI të Colgate përfshijnë të gjitha pajisjet, programet, pajisje të lëvizshme, të dhëna dhe pajisje ruajtëse të së tashmes dhe të ardhmes, që janë në pronësi, me qira apo të vendosura në dispozicion nga Colgate. Burimet TI të Colgate duhen përdorur në mënyrë të respektueshme dhe profesionale vetëm për qëllime biznesi të Colgate, përveç rasteve të përdorimit personal të kufizuar dhe të përshtatshëm.

### **Burimet TI të Colgate nuk duhen përdorur:**

- Për të dërguar mesazhe ngacmuese, diskriminuese, fyese, diskredituese, mashtruese apo kërcënuese.
- Për të nxjerrë në mënyrë të paligjshme informacionin e rezervuar, konfidencial apo sekretin tregtar të kompanisë apo të një pale të tretë.
- Për të shkakuar apo lejuar shkeljen e sigurisë apo ndërhyrjet me rrjetin e Colgate apo me sistemet e komunikimit duke përfshirë, por pa u kufizuar në, futjen apo transmetimin e krimbave, viruseve, softuerëve "spiunë", softuerëve "keqdashës", apo çdo përmbajtjeje apo kodi tjetër të një natyre dashakeqe apo shkatërruese.
- Për të shmangur kontrollet e qasjes së përdoruesit apo siguri të tjera të çdo kompjuteri, rrjeti, aplikacioni apo ndonjë teknologjie tjetër.

- Për të cenuar të drejtat e ndonjë personi apo kompanie të mbrojtur nga marka tregtare, karakteristikat vizuale, të drejtën e reklamimit/privatësisë, të drejtën e autorit, sekretin tregtar, patentën apo çdo të drejtë tjetër të pronësisë intelektuale, apo ligje e rregullore të ngjashme.
- Për të cenuar të drejtat e reklamimit dhe privatësisë të çdo personi të mbrojtur nga ligjet në fuqi.
- Për të bërë thirrje për ndërmarrje të tjera tregtare, për kauza fetare apo politike, apo për çdo përfitim apo avantazh personal të paautorizuar.
- Për të instaluar ose shkarkuar programe të paautorizuara në sistemin e Colgate, për qëllime pune apo personale.
- Për çdo përdorim tjetër të ndaluar nga Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit.
- Me përjashtim të rasteve kur kufizohet nga ligjet në fuqi, Colgate rezervon të drejtën për të rishikuar të gjitha përdorimet dhe për të kufizuar, pezulluar apo përfunduar qasjen ndaj burimeve TI në çdo kohë dhe për çdo arsye. Punonjësit nuk duhet të kenë pritshmëri privatësie kur përdorin Burimet TI të kompanisë.

### **Burimet TI të Colgate:**

- Duhet të përdoren për të gjithë biznesin e kompanisë. Për këtë qëllim, burimet TI të Colgate përfshijnë pajisje celulare personale që janë miratuar nga politika e sigurisë së pajisjeve celulare për sigurinë globale të informacionit dhe janë në përputhje me të.
- Adresat e emailit personal nuk duhet të përdoren për të kryer biznes të kompanisë,
- Punonjësit e Colgate nuk duhet të dërgojnë dokumente ose emaille të kompanisë në adresa emaili personale dhe prej tyre.



## Inteligjenca artificiale (IA)

Një sistem i inteligjencës artificiale është një sistem i automatizuar i cili mund të gjenerojë rezultate të tilla si parashikime, rekomandime, përmbajtje në forma të ndryshme (si tekste, imazhe, video dhe tinguj), ose vendime që ndikojnë në mjediset reale ose virtuale. Sistemet e IA-së ofrojnë një mjet të fuqishëm për përmirësimin e proceseve tona të biznesit, përmirësimin e përvojave të klientëve dhe konsumatorëve, si dhe për nxitjen e inovacionit në të gjitha operacionet tona. Megjithatë, sistemet e IA-së shoqërohen me përgjegjësi dhe rreziqe të mundshme për Kompaninë, punonjësit tanë dhe grupet e tjera të interesit. Ne inkurajojmë zbatimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të sistemeve të IA-së, duke nënvizuar rëndësinë e gjykit të shëndoshë, të pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe me standardet etike për të zbutur pasojat e paqëllimshme.

### Parimet për përdorimin e përgjegjshëm të IA-së

- Ne veprojmë në mënyrë etike dhe me integritet dhe respektojmë ligjin: Ne angazhohemi të përdorim sistemet e IA-së në përputhje me vlerat dhe qëllimet tona, duke garantuar pajtueshmëri me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, Kodin tonë të Sjelljes dhe Udhëzimet e Praktikave të Tregtisë Globale, me fokus të veçantë në mbrojtjen e privatësisë së të dhënave dhe sigurimin e konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave. Ne jemi të angazhuar të veprojmë në mënyrën e duhur dhe me integritet.
- Ne nxitim besimin dhe llogaridhënien: Ne përpiqemi të ruajmë transparencën në metodat, zbatimet dhe përdorimet e sistemeve tona të IA-së, brenda kufijve të sigurisë, ligjeve dhe politikave, ndërsa zhvillojmë mekanizma për caktimin e përgjegjësive dhe garantimin e llogaridhënies për rezultatet e IA-së. Ne do të veprojmë me përgjegjshmëri për të ruajtur besimin e të gjithë aktorëve.
- Ne mbështesim drejtësinë dhe përfshirjen: Ne prioritojmë drejtësinë dhe përfshirjen e perspektivave të ndryshme në përdorimin e IA-së. Ne do të identifikojmë në mënyrë proaktive gjykimet e mundshme të njëanshme në praktikën tona të IA-së dhe do të ndërmarrim hapa për t'i zbutur ato. Ne përpiqemi të përfaqësojmë perspektiva të ndryshme dhe të zbusim gjykimet e njëanshme.
- Ne prioritojmë zbatimin e IA-së me në qendër përdoruesin: Ne prioritojmë përforcimin e aftësive njerëzore, duke ofruar qartësi në ndërveprimet me IA-në dhe duke siguruar transparencë në përdorimin tonë të teknologjisë. Ne do të punojmë për t'i përdorur sistemet e IA-së në një mënyrë që u vjen në ndihmë njerëzve tanë dhe komuniteteve të tyre.
- Ne angazhohemi të garantojmë sigurinë në përdorimin e IA-së: Ne jemi të dedikuar të zbatojmë praktikën më të mirë të sigurisë për të përforcuar qëndrueshmërinë dhe për të menaxhuar rrezikun e lidhur me IA-në. Ne do të punojmë për të mbrojtur organizatën dhe grupet e interesit nga rreziqet e sigurisë.



## Mediat sociale

“Media sociale” është termi përcaktues për faqet, aplikacionet dhe mjetet e tjera të komunikimit në internet që i lejojnë përdoruesit të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në internet duke ndarë informacion, mendime, njohuri dhe interesa. Mjetet e medias sociale përfaqësojnë një mënyrë të vlefshme që ne të lidhemi me njëri-tjetrin, si edhe me klientët, furnitorët, konsumatorët dhe specialistët tanë. Ndërsa këto mjete të mediave sociale kanë tepër përfitime, ato gjithashtu mund të shfaqin rreziqe për Kompaninë, për punonjësit që përdorin mediat sociale dhe për palë të tjera të treta. Ne ju nxitim të përfshiheni në mediat sociale në një mënyrë të përgjegjshme, të përdorni gjykim të shëndoshë dhe të tregoni përgjegjësi personale për të shmangur çdo pasojë të padëshiruar kur publikoni në media të tilla. Për shembull, ju duhet të shmangni publikimin e çdo komenti që nuk do të ishte komodë t’ia bënit dikujt tjetër drejtpërdrejt. Përveç kësaj, ka kërkesa rigorozë për bërjen e deklaratave në emër të Colgate.

### **Përdorimi personal i mediave sociale - Gjërat e lejuara dhe të palejuara**

- MOS përdorni ose përfshini adresa emaili të kompanisë në ndërveprimet tuaja personale në mediat sociale.
- Nëse dëshironi ta bëni, IDENTIFIKONI veten si një punonjës i kompanisë nëse merrni pjesë në faqe mediash sociale si individ (p.sh., një llogari personale në "Facebook" ose "Twitter"), por MOS përdorni emrin e kompanisë, filialeve të saj, ndërmarrjeve të përbashkëta ose ndonjë prej produkteve të tyre si emër përdoruesi ose emër në ekran.
- MOS përdorni logo ose materiale në pronësi të kompanisë, përveçse kur ato janë të identifikuara si të miratuara nga Colgate.
- MOS u përfshini në komunikim me konkurrentët ose të tjerë në një mënyrë të papërshtatshme (për shembull, duke ndarë informacion konfidencial apo të rezervuar të kompanisë).
- Nëse bëni rekomandime për produktet Colgate ose publikoni rreth temave që kanë lidhje me kompaninë në faqet personale të mediave sociale, VEPRONI në përputhje me kodin tonë dhe me ligjin:
  - ZBULONI në çdo publikim të tillë se ju punoni për kompaninë (për shembull, #ColgateTeam ose #IamColgate), kur kërkohet nga ligji.
  - Nëse ju vijnë pyetje në lidhje me kompaninë ose produktet e saj në faqet personale të mediave sociale, MOS provoni t’u përgjigjeni vetë çështjes. Përkundrazi, OFRONI një lidhje me një faqe interneti të kompanisë që e trajton çështjen, ose përcilleni pyetjen te seksioni "Na kontaktoni" i ColgatePalmolive.com për një përgjigje.
  - Pranojeni se njerëzit mund të mos ju veçojnë nga punëdhënësi juaj. Pavarësisht platformës së medias sociale, duhet të jeni të vetëdijshëm për ndikimin që kanë fjalët dhe veprimet tuaja në reputacionin tuaj dhe atë të Colgate-Palmolive dhe të shmangni publikimet personale që mund të kenë ndikojë negativisht në reputacionin e Colgate.


## **Përdorimi i mediave sociale nga kompania**

Kompania ka procese të mirëpërcaktuara të komunikimit të lajmeve, tregtimit të produkteve dhe përfshirjes në reklamim në faqe interneti të sponsorizuara nga kompania. Ju nuk duhet të publikoni në këto faqe në emër të kompanisë, përveç nëse jeni autorizuar për ta bërë këtë. Nëse jeni autorizuar për t'u përfshirë në këtë veprimtari, ju lutemi referojuni kapitullit 16, "Mediat sociale" të Udhëzuesit të Praktikave të Biznesit për të shqyrtuar udhëzimet përkatëse.

## **Referencat ndaj kompanisë**

Nëse vini re publikime të pasakta ose të papërshtatshme që mund të ndikojnë te kompania ose reputacioni i kompanisë, kontaktoni me Departamentin për Komunikimet e Korporatës (Corporate Communications) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë (Ethics & Compliance).

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve të teknologjisë së informacionit dhe mediave sociale, që mund të gjenden në **Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit**.



***Marrëdhënia  
me subjekte  
të biznesit  
jashtë  
kompanisë***

Ne kryejmë biznes me ndershmëri dhe integritet dhe presim që vlerat dhe praktikat e biznesit të palëve të treta të pasqyrojnë vlerat dhe praktikat tona për sa i përket pajtueshmërisë me ligjin, cilësisë e produktit, sigurisë, të drejtave të njeriut dhe trajtimit të punonjësve.



### **Ne mbajmë marrëdhënie etike me palët e treta**

Angazhimi ynë për të krijuar një mjedis besimi dhe respekti, ku ka komunikim të hapur dhe të ndershëm, shtrihet dhe në marrëdhënien tonë me palët e treta. Marrëdhëniet e ndershme e të drejta me palët e treta janë të qenësishme për të krijuar marrëdhënie të forta e jetëgjata biznesi. Të gjitha palët e treta të mundshme i trajtojmë në mënyrë të paanshme dhe të njëjtë. Vendimet për zgjedhjen e furnizuesve bazohen në kritere objektive, të tilla si çmimi dhe cilësia, si dhe ndershmëria dhe besueshmëria.

Gjithashtu ne nuk i bëjmë favore personale palëve të treta sa i përket çmimeve, zbritjeve reklamuese, asistencës në marketing apo gjërave të ngjashme me këto. Marrëdhënia me palët e treta diskutohet më gjerësisht në pjesën e këtij Kodi që trajton Marrëdhënien Tonë me Shtetin dhe Ligjin.

Kodi i Sjelljes së Palëve të Treta i Colgate u zhvillua për të përçuar pritshmëritë tona lidhur me sjelljen etike që presim nga palët e treta me të cilat ne punojmë.

Furnizuesit dhe furnitorët e Colgate duhet të këshillohen gjithmonë në lidhje me kërkesën për t'iu përmbajtur Kodit të Sjelljes së Palëve të Treta kur punojnë me

ne ose përndryshe do të vihen përballë humbjes së mundshme të biznesit tonë, nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë. Përveç kësaj, ne duhet të respektojmë dhe veprojmë në përputhje me politikat e klientëve ose furnizuesve deri në shkallën ku ato nuk janë në kundërshtim me tonat. **Kodi i Sjelljes së Palëve të Treta i Colgate** disponohet në disa gjuhë.



### **Ne nuk japim ose pranojmë dhurata të papërshtatshme**

Është e papranueshme që të ofroni, jepni ose të merrni dhurata, pagesa, përfitime ose oferta punësimi (qoftë drejtpërdrejt te ju ose prej jush, ose jo drejtpërdrejt nëpërmjet një anëtari familjeje ose të njohuri) për të influencuar ose që duket sikur po influencojnë ndonjë vendim biznesi. Nëse keni për qëllim të jepni, keni dhënë, ju është ofruar apo keni marrë një dhuratë, pagesë apo një tjetër përfitim, dhurata/përfitimi nuk mund të kalojë vlerën nominale (rreth 100 USD). Dhuratat kurrë nuk duhet të jenë në para, në ekuivalentët e parasë apo në letra me vlerë. Gjithashtu, keni parasysh se ju mund të jepni ose pranoni një dhuratë me vlerë nominale në drejtim apo të marrë nga një burim i vetëm, një herë përgjatë një viti kalendarik.

Nëse besoni se dhurata, pagesa apo përfitimet e tjera ju janë ofruar apo dhënë për qëllim ndikimi në një vendim biznesi, ju duhet të kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance).

Nëse do të ishte e sikletshme për Kompaninë që ju të mos e pranoni një dhuratë që e kalon vlerën nominale, qëllimi juaj për të pranuar dhuratën duhet rishikuar me Organizatën Ligjore Globale

(Global Legal Organization). Përveç kësaj, mos bini në ujdi ose pranoni një dhuratë, pagesë ose përfitim tjetër që është më shumë se nominale në vlerë, në emër të një pjesëtari të afërt të familjes prej kujtdo me të cilin kompania ka një marrëdhënie ekzistuese biznesi ose me të cilin dëshiron të krijojë një marrëdhënie biznesi në të ardhmen.

Ndiqni këtë rregull: mos jepni apo pranoni kurrë një dhuratë apo shërbim nëse kjo gjë ju komprometon apo duket sikur po ju komprometon. Kjo nuk përfshin programe zbavitëse të herëpashershme biznesi ose dhurata me vlerë nominale.

Duhet të kini parasysh se ka rregulla të veçanta që qeverisin sjelljen e përshtatshme kur kemi të bëjmë me zyrtarët federalë, shtetërorë, lokalë ose të qeverive të huaja, të cilat ndryshojnë nga rregullat për punën me subjektet joqeveritare. Asnjë dhuratë apo send tjetër, pavarësisht vlerës, nuk i duhet dhënë apo marrë nga ndonjë punonjës qeveritar ose nëpunës qeveritar në asnjë shtet pa marrë paraprakisht miratim me shkrim nga Organizata Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion të mëtejshëm lidhur me dhuratat për zyrtarët qeveritarë apo qeveritë, duke iu referuar Politikës Globale të Shpenzimeve Qeveritare dhe formularit dhe procesit të miratimit të lidhur me këtë çështje.




## ***Ne i respektojmë sekretet tregtare dhe informacionin konfidencial***

Është politikë e Colgate që të mos shkelë në mënyrë të ndërgjegjshme të drejtat e pronësisë intelektuale të vlefshme dhe të

zbatueshme të tjerëve. Është gjithashtu politikë e kompanisë që të respektojë sekretet tregtare ose informacione të tjera të rezervuara të tjerëve. Kjo ka veçanërisht rëndësi në qoftë se keni hyrë te Colgate dhe keni njohuri të sekreteve tregtare dhe informacionit të rezervuar të një ish-punëdhënësi. Në përgjithësi, marrja në punë e punonjësve apo ish-punonjësve të konkurrentëve tanë, nuk është e ndaluar. Megjithatë, marrja në punë nga konkurrentët tanë të drejtpërdrejtë mund të shfaqë një rrezik ligjor që duhet administruar, duke përfshirë këtu dhe rrezikun e marrjes së informacionit konfidencial apo të rezervuar të konkurrentëve tanë apo palëve të treta. Në qoftë se ju lind ndonjë pyetje në këtë fushë, duhet të konsultoheni me Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Nëse dikush nga jashtë kompanisë ju afrohet me një shpikje, zbulim ose ide, është e rëndësishme ta mbron kompaninë nga shkeljet e ardhshme ose pretendimet për përfitim parash. Mos i lejoni të jashtmit që t'ju zbulojnë të dhëna për shpikjen, zbulimin ose idenë e tyre të re pa u konsultuar më parë me Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).


Udhëzimet gjenden në faqen e jashtme të internetit [www.colgate.com/innovation](http://www.colgate.com/innovation), së bashku me formularët dhe procesin që duhet ndjekur për ata të cilët duan të kryejnë një dorëzim të tillë. Nëse merrni një ide, sugjerim apo kërkesë të pakërkuar, ju duhet ta drejtoni personin te faqja jonë e jashtme e internetit dhe ta udhëzoni atë që të ndjekë procesin e shpjeguar aty.



***Marrëdhënia  
me  
konsumatorët***

Drejtojini të gjitha palët që ju afrohen me ide të pakërkua, ose tek Organizata Ligjore Globale (Global Legal Organization), ose te Departamenti i Çështjeve të Konsumatorëve (Consumer Affairs Department) në qendrën tuaj, për trajtim në përputhje me procedurat e kompanisë.

Emri i mirë i kompanisë sonë është ndërtuar në bazë të cilësisë dhe sigurisë së produkteve tona. Angazhimi jonë për shëndetin dhe sigurinë e Klientit është i domosdoshëm për vazhdimin e rritjes dhe suksesit të Kompanisë.



## **Ne vendosim standardet më të larta për produktet tona**

Ne jemi të përkushtuar të sigurojmë besimin e konsumatorëve në produktet Colgate për besueshmërinë, cilësinë dhe funksionimin e tyre të shkëlqyer. Përveç shërbimit ndaj miliarda personave në tregjet ku ne zhvillojmë biznes, duhet të përpiqemi të prodhojmë produkte në mënyrën më të efektshme të mundshme në mënyrë që të dalim me oferta të përballueshme për produktet.

Produktet që shiten nga Colgate jo vetëm që duhet të përmbushin të gjitha standardet e sigurisë të përcaktuara me ligj, por edhe standardet e kompanisë tonë që shpesh janë më të rrepta. Ne marrim pjesë në programe për t'u dhënë ndihmë të menjëhershme konsumatorëve në rastet kur dyshohet për ndërhyrje, keqpërdorim ose produkte të falsifikuara. Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e konsumatorit janë të rëndësishme parësore për ne dhe si punonjës i Colgate është përgjegjësia juaj që t'i raportoni menjëherë drejtuesit të njësisë tuaj të biznesit çdo çështje që hasni në lidhje me cilësinë ose sigurinë e produktit.

Për informacione të mëtejshme lidhur me sigurinë e përbërësve tanë, ju lutemi referojuni **Politikës Tonë mbi Sigurinë e Përbërësve: Fitimi i besimit tuaj për breza të tërë, çdo ditë.**



## **Ne u përgjigjemi konsumatorëve**

Meqenëse biznesi ynë ka të bëjë me produkte konsumatore, sukcesi ynë varet nga kënaqësia, besimi dhe dashamirësia e konsumatorit. Ne mund të arrijmë më së miri objektivat tona dhe t'u shërbejmë nevojave të konsumatorëve, duke ndjekur një program të qëndrueshëm dhe të drejtë të komunikimit me konsumatorët.

Ne e dimë sa rëndësi ka parashikimi dhe përgjigjja ndaj nevojave dhe preferencave të konsumatorëve. Ne mendojmë gjithashtu se mendimet, shqetësimet dhe kërkesat e konsumatorëve që i vijnë kompanisë në lidhje me produktet tona janë burime të rëndësishme informacioni. Nevojat e konsumatorëve ndryshojnë vazhdimisht, prandaj ne duhet që vazhdimisht të dëgjojmë se çfarë duan njerëzit për plotësimin e këtyre nevojave në ndryshim.

Kur një konsumator shpreh pakënaqësi, ekipi i Çështjeve të Konsumatorëve do ta shqyrtojë problemin menjëherë, me mirësjellje dhe drejtësi dhe do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të ruajtur ose rifituar dashamirësinë e konsumatorit.



## **Reklamimi ynë është i ndershëm dhe i saktë**

Një nga aspektet më të rëndësishme të biznesit tonë është reklamimi. Reklamimi duhet të jetë krijues dhe konkurrues, por gjithashtu duhet të jetë i ndershëm, i saktë, të mos jetë çorientues dhe të jetë në përputhje me të të gjitha ligjet në fuqi.

Reklamimi krijon më tepër se një imazh të produktit. Ai ndërton emrin tonë për besueshmëri, varësi dhe besim.

Përveç kësaj, ne tregojmë kujdes për zgjedhjen e medias në të cilën shfaqen mesazhet e reklamimit tonë. Ne nuk lejojmë që reklamat tona të shfaqen në mjedise që nuk janë në përputhje me vlerat e kompanisë sonë; këtu përfshihet çdo përmbajtje që:

- Portretizon dhunë të panevojshme ose të tepërt.
- Konsiderohet nga Colgate si program antisocial apo me shije të keqe, apo që mund të stimulojë sjellje antisociale të imituar nga ndjekësit e programit.
- Përmban sjellje seksuale që konsiderohen fyese.
- Mbështet apo nënkupton mbështetjen e veprimeve që çojnë në abuzimin fizik apo mendor të një individi.
- Fyen, përqesh apo denigron njerëzit për shkak të moshës, kombësisë apo origjinës etnike, nënshtetësisë, gjinisë apo identitetit gjinor, orientimit seksual, racës, fesë, nënshtetësisë apo që angazhohet në stereotipe të papranueshme.
- Shpreh pikëpamje ose opinione politike.


Për të garantuar mbajtjen e këtij premtimi në një mjedis që vjen duke u dixhitalizuar gjithnjë e më tepër, ne kërkojmë përdorimin e teknologjisë së sigurisë së markës të palës së tretë në reklamat tona dixhitale në masën më të madhe të mundshme.

Së fundi, ne e shpërblejmë besimin dhe respektin që njerëzit na japin kur blejnë produktet tona duke zbatuar ligjet në fuqi dhe duke përdorur standardet më të larta etike dhe morale për privatësinë lidhur me përdorimin e të dhënave në komunikime.

Ne ndjekim standardet e paanshmërisë komerciale në përgatitjen, përdorimin dhe zgjedhjen e reklamave, markave tregtare dhe dizenjove, me qëllim që produktet tona të kenë sukses më tepër në bazë të fuqisë së vetë cilësisë së tyre dhe emrit të mirë, se sa nëpërmjet imitimit ose tregtimit në bazë të dashamirësisë së konkurrentëve. Drejtësia komerciale kërkon:

- Respektim rigoroz të kërkesave ligjore vendore, në lidhje me shkeljet e markave tregtare dhe konkurrencën e pandershme.
- Shmangien e kopjimit të markave tregtare, parullave, temave të reklamimit dhe arteve grafike të mirënjohura që përdoren nga kompani shumëkombëshe dhe konkurrentë rajonalë.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi reklamimin dhe vendosjen e reklamimit, që mund të gjenden në **Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit**.



# *Marrëdhënia me ligjin*

## **Ne veprimet në përputhje me ligjet përkatëse**

Punonjësit e Colgate duhet t'i kryejnë bizneset e kompanisë në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje të plotë me ligjet e vendeve në të cilat operojnë, si dhe ligjet përkatëse të Shteteve të Bashkuara siç përvijohen në politikat, procedurat dhe Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit të kompanisë. Nëse besoni se ka konflikt mes ligjeve vendore dhe ligjit përkatës të SHBA-së ose politikës së Kompanisë, ju lutemi konsultohuni me Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

## **Ne veprimet në përputhje me ligjet për konkurrencën**

Colgate dhe të gjithë punonjësit duhet të veprojnë në përputhje me ligjet për konkurrencën (të njohura si ligjet kundër monopolit në Shtetet e Bashkuara) të çdo vendi, shteti dhe lokaliteti ku ne kryejmë biznes. Qëllimi i këtyre ligjeve është që të mbrojnë konsumatorët ose kompanitë e tjera duke u siguruar që kompanitë të konkurrojnë ndershmërisht, duke ofruar çmime konkurruese, produkte më novatore dhe shërbim më të mirë dhe që kompanitë të mos ndërhyjnë te forcat e tregut të kërkesës dhe ofertës. Pothuajse çdo vend ka nxjerrë ligje për konkurrencën. Është përgjegjësia e gjithsecilit që të kuptojë ligjet për konkurrencën që janë në fuqi aty ku zhvillon biznes Colgate dhe që të kërkojë udhëzime kur është e nevojshme nga Organizata Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Ligjet e konkurrencës në të gjithë botën i ndalojnë marrëveshjet mes konkurrentëve, të cilat mund të kenë ndikim në dëmtimin

e konkurrencës. Çelësi i pajtueshmërisë është pavarësia. Colgate duhet të veprojë në mënyrë të pavarur në aktivitete të ndryshme biznesi:

- ✓ Caktimi i çmimit
- ✓ Uljet apo promovimet
- ✓ Kushtet e blerjes apo shitjes
- ✓ Përzgjedhja e klientëve, shpërndarësve ose furnizuesve
- ✓ Zgjedhjet se cilat produkte duhen prodhuar dhe ç'sasi duhet shitur
- ✓ Punësimi i punonjësve

Është e rëndësishme të mos harrojmë se një marrëveshje e paligjshme nuk është e thënë që të jetë një dokument zyrtar apo edhe me shkrim. Mund të jetë një marrëveshje me gojë ose thjesht që nënkuptohet gjatë kryerjes së biznesit ose nga komente të rastësishme. Gjithashtu nuk është e thënë që marrëveshja duhet të vihet në zbatim me sukses për të qenë e paligjshme.

Pavarësia e kompanive mund të ndikohet dhe mund të nënkuptohet si marrëveshje e paligjshme kur konkurrentët ndajnë ose marrin informacion konfidencial ose jopublik rreth planeve aktuale ose të ardhshme të biznesit (p.sh. një rritje e planifikuar çmimi, kosto që tarifohen nga furnitorët, nxjerrje të produkteve të reja, planet e rekrutimit dhe punësimin etj.). Kjo është veçanërisht e rëndësishme të mbahet mend gjatë anketave të shoqatave tregtare dhe takimeve. Normalisht, ju duhet të merrni miratimin e Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization) përpara se të merrni pjesë në ndonjë takim (qoftë personalisht, virtualisht ose nëpërmjet platformave të mediave sociale si "Facebook" ose "Whatsapp") ku mund të jetë i pranishëm edhe një konkurrent. Nuk duhet ta nxirrni kurrë informacionin

konfidencial të kompanisë të konkurrentët. Nëse merrni informacione rreth një konkurrenti që mendoni se mund të jenë konfidenciale, duhet të njoftoni menjëherë Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization). Nuk duhet ta përdorni ose ta ndani këtë informacion pa marrë më parë miratim ligjor.

Ligjet e konkurrencës gjithashtu mbrojnë ndaj veprimeve grabitqare ose të padrejta të kompanive dominuese, me qëllim që fusha e lojës konkurruese të jetë e drejtë dhe e hapur. Veprimet që mund të jenë të ligjshme nëse merren nga kompani që nuk janë dominuese, mund të konsiderohen të paligjshme nga pjesëmarrës dominues. Në shtete ku Colgate ka një pjesë të madhe të tregut, duhet të konsultoheni me përfaqësuesin ligjor vendas për t'u siguruar që disa veprime të menduara (p.sh. një politikë specifike e uljes ose refuzim për të shitur) nuk do të quhet abuzim i pozicionit dominues.

Ligjet e konkurrencës imponojnë gjithashtu kufizime të caktuara në marrëdhëniet me furnizuesit dhe klientët dhe shpërndarësit e tyre. Në shumicën e vendeve, çdo përpjekje për t'u mohuar klientëve ose shpërndarësve lirinë për të vendosur çmimet ose termat dhe kushtet e shitjes, ose vënia e kufizimeve në lidhje me të drejtën e tyre për të vepruar në mënyrë të pavarur, shkel ligjet për konkurrencën. Është e rëndësishme t'u theksojmë klientëve që “çmimet tona të rekomanduara të shitjes me pakicë (ose rishitjes)” janë pikërisht ashtu, të rekomanduara. Klientët janë gjithmonë të lirë t'i shesin me çfarëdo çmimi që të zgjedhin.

Pasojat e shkeljes së ligjeve për konkurrencën janë tejet të rënda dhe mund të çojnë në gjoba të mëdha për kompaninë dhe dënime (përfshirë heqje lirie) për çdo individ të përfshirë. Edhe hetimet për sjellje të mundshme antikonkurruese mund të shkaktojnë një dëm të madh të emrit dhe shkatërrim të biznesit.

Nëse keni ndonjë dyshim nëse një veprim i synuar mund të ngrejë çështje në bazë të ligjeve për konkurrencën, duhet të konsultoheni me Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi ligjet për konkurrencën, që mund të gjenden në **Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit**.

## ***Ne veprojmë në përputhje me ligjet për letrat me vlerë***

Ka raste kur mund të keni kontakt me informacion për Colgate ose kompani të tjera që tregtohen publikisht me të cilat Colgate kryen biznes që nuk dihet nga publiku (“informacion jopublik”), të tilla si rezultate financiare ose të operimit, shkrirje ose blerje të mundshme, likuidime ose financime të mundshme, plane marketingu ose prezantime të produkteve të reja.

Informacioni konsiderohet jopublik derisa t'i jetë shpallur publikut siç duhet, d.m.th. derisa informacioni të jetë shpërndarë gjerësisht dhe të ketë kaluar kohë e mjaftueshme që tregjet e letrave me vlerë të reagojnë ndaj informacionit. Në qoftë se ky informacion jopublik mund të konsiderohej “material”, domethënë, informacion që një investitor i matur do ta merrte parasysh gjatë marrjes së një vendimi investimi,

atëherë duhet të pajtoheni me ligjet e mëposhtme të letrave me vlerë dhe politikën e kompanisë:

- ✓ Nuk duhet të tregtoni për llogarinë tuaj, ose për llogarinë e një personi tjetër, stoqe, obligacione ose letra të tjera me vlerë të firmës (Colgate ose tjetër), me të cilën ka të bëjë informacioni material jopublik;
- ✓ Nuk duhet t'i inkurajoni ose nxisni të tjerët, në bazë të informacionit të tillë jopublik, që të tregtojnë stoqe, obligacione ose letra të tjera me vlerë të firmave të tilla;
- ✓ • Nuk duhet që informacion të tillë jopublik t'ua jepni personave jashtë Colgate; dhe
- ✓ Nuk duhet ta diskutoni informacionin e tillë jopublik me persona brenda Colgate, përveçse kur ata kanë nevojë të jenë në dijeni të këtij informacioni.

Me fjalë të tjera, nuk mund të përdorni asnjë informacion jopublik që mësoni nëpërmjet punësimi tuaj te Colgate për të përfituar vetë ose të tjerët në transaksionet e letrave me vlerë ose investimeve.

Nëse mësoni informacione jopublike në punën te Colgate, duhet të bëni kujdes që ta mbani informacionin konfidencial dhe nuk duhet të kryeni asnjë tregti (ose të këshilloni dikë tjetër të kryejë tregti) në letra me vlerë të Colgate ose të kompanive të tjera që ndikohen, derisa të kalojë një periudhë e arsyeshme kohore pasi informacioni i shpallet publikut. Ky ndalim përfshin ushtrimin e opsioneve të stoqeve dhe çdo vendim për të investuar në stoqe të Colgate ose shitjen e tyre nëpërmjet planeve të përfitimeve të kompanisë.

Detyrimi juaj për ruajtjen e fshehtësisë së informacionit të tillë jopublik vazhdon pas punësimi tuaj me Colgate derisa ky informacion t'i jetë shpallur publikut ashtu siç duhet.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje nëse informacioni është “material” ose nëse i është shpallur siç duhet publikut, duhet të kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) dhe duhet të mos i tregtoni letrat me vlerë të ndikuara apo të nxirrni informacionin, derisa të keni marrë miratim ligjor.

## ***Ne veprojmë në përputhje me ligjet kundër ryshfetit***

Colgate është e përkushtuar që të veprojë në mënyrë të ligjshme dhe etike me qeveritë dhe punonjësit e qeverive kudo në botë. Politika e kompanisë, si dhe Ligji Amerikan për Praktikën e Huaja Korruptuese (“FCPA”) dhe ligje të ngjashme kundër ryshfeteve në të gjithë botën i ndalojnë punonjësit tanë ose këdo që vepron në emrin tonë në lidhje me bizneset tona që t'i japë ose ofrojë diçka me vlerë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë ndonjë zyrtari qeveritar për të përfituar një biznes ose për të ndikuar te ndonjë ligj ose vendim qeveritar.

Politika e kompanisë dhe disa ligje përkatëse ndalojnë gjithashtu çdo pagesë lehtësuese ose “shpërblyese” të bërë për zyrtarët qeveritarë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, për të shpejtuar një shërbim ose funksion zyrtar (për shembull, pagesa të vogla për ta bërë një zyrtar që ta zhvendosë aplikimin e Colgate në fillim të radhës ose

për të shkurtuar afatin kohor për të cilat ofrohen këto shërbime ose veprime të tjera). Çdo tarifë zyrtare që bazohet në fatura apo dëftesa pagese të lëshuara nga qeveria nuk klasifikohet si pagesë e papërshtatshme.

Për t'u siguruar që ju nuk do ta shkelni këtë standard, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një pale të tretë, politika e kompanisë është që, përveç tarifave të dhëna ligjërisht që mbështeten me një faturë zyrtare (p.sh. tarifat e lejes ose të licencës), asnjë pagesë, argëtim, udhëtim, dhurata ose sende të tjera me vlerë nuk duhet t'u jepen ose t'u ofrohen zyrtarëve qeveritarë, pavarësisht sasisë së vlerës, përveç rasteve kur miratohet paraprakisht me shkrim nga Organizata Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion të mëtejshëm duke iu referuar **Politikës Globale të Shpenzimeve Qeveritare** dhe **Formularit të Miratimit** në lidhje me këtë çështje.

Është e rëndësishme të dini që termi “zyrtarë qeveritarë” përkufizon gjerësisht dhe përfshin individë që janë të punësuar nga çfarëdolloj institucioni ose organizate publike ose të lidhur me shtetin, ose që veprojnë në cilësi zyrtare në ndonjë mënyrë, me kohë të plotë, kohë të pjesshme ose pa pagesë. Zyrtarët qeveritarë mund të gjenden në çdo degë dhe nivel të jetës qeveritare dhe publike dhe mund të përfshijnë këdo, nga punonjës doganash të nivelit të ulët deri në hartues ligjesh të nivelit të lartë, si dhe profesorë dhe mësues, dentistë, veterinerë ose profesionistë të tjerë dhe udhëheqës të rëndësishëm të mendimit si dhe punonjës të degëve të medias që zotërohen nga shteti. Nëse keni dyshime nëse një individ

mund të konsiderohet zyrtar qeveritar, duhet të kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Jini gjithmonë i drejtë dhe i ndershëm gjatë veprimeve dhe komunikimeve me punonjësit e qeverisë. Çdo deklaratë e rreme me dijeni dhe vullnet të plotë ndaj punonjësve të qeverisë (me gojë ose shkrim), mund t'ju ekspozojë ju dhe kompaninë ndaj dënimeve të mëdha.

Përveç ndalimit të dhënies së ryshfetit zyrtarëve qeveritarë, politika e kompanisë dhe ligjet përkatëse ndalojnë gjithashtu ryshfetin ndaj palëve private. Ju nuk duhet të përpiqeni që të influenconi gjykimin ose sjelljen e ndonjë pale të jashtme me të cilën mund të jeni duke kryer biznes të kompanisë duke premtuar dhurata, pagesa ose përfitime të tjera, ose nëpërmjet ndonjë nxitjeje tjetër të paligjshme.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion të mëtejshëm duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi bashkëveprimin me punonjësit qeveritarë dhe qeveritë, që mund të gjenden në **Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit**.

## **Ne veprojmë në përputhje me rregullat ndërkombëtare të tregtisë**

Kompania vepron në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare dhe duhet të veprojë gjithashtu në përputhje me rregullat tregtare amerikane, pavarësisht se ku funksionojmë në botë.

Ligjet e sanksioneve të tregtisë rregullojnë importin dhe eksportin dhe gjithashtu mund ta ndalojnë kompaninë që të

kryejë biznes me disa shtete ose me disa individë ose subjekte. Përpara angazhimit të ndonjë pale të tretë (furnizues, klient etj.), pala e tretë duhet të kontrollohet te dy listat e “Palëve të kufizuara” që mbahet nga qeveria e SHBA-së për t’u siguruar që kompania është e lirë të vijojë me transaksionin.

Përveç kësaj, kompania duhet të veprojë në përputhje me ligjet e Shteteve të Bashkuara të hartuara për të garantuar që kompanitë amerikane të mos marrin pjesë në bojkote që nuk janë të sanksionuara nga Shtetet e Bashkuara. Këto ligje janë të zbatueshme për të gjitha zyrat dhe për të gjithë punonjësit, filialet dhe bashkëpunëtorët e Colgate pavarësisht se në ç’pjesë të botës ndodhen. Çdo kërkesë për të marrë pjesë në një bojkot të pasanksionuar (edhe nëse ne e refuzojmë kërkesën) duhet t’i raportohet menjëherë Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization) për trajtimin e duhur të saj.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi marrëdhëniet ndërkombëtare tregtare, që mund të gjenden në **Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit**.

## **Ne veprojmë në përputhje me ligjet për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave**

Colgate e respekton privatësinë e punonjësve të saj, konsumatorëve, klientëve, furnizuesve dhe palëve të treta të tjera me të cilët Colgate ka marrëdhënie biznesi dhe si rrjedhim, ne i trajtojmë me përgjegjësi të dhënat personale dhe në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Si pjesë e punësimit të tyre me Colgate, punonjësit i japin kompanisë një nivel të caktuar të dhënash personale, si për shembull adresën e shtëpisë dhe postën elektronike, si dhe informacionin lidhur me familjen që shërben për administrimin e marrëdhënies së punësimit.

Në mënyrë të njëjtë, konsumatorët tanë mund të japin të dhëna personale si emri, adresat e shtëpisë dhe postës elektronike, lidhur me marrëdhënien e tyre me Kompaninë.

Gjatë periudhës së marrëdhënies të biznesit me Colgate, konsumatorët, furnitorët dhe palët e tjera të treta mund t’i japin kompanisë informacion personal, si emra, numra telefoni, adresa banimi, adresa emaili dhe informacion për kartën e kreditit.

Në lidhje me të gjithë këtë informacion, është politika e Colgate që:

- ✓ Të japë njoftim të përshtatshëm përpara se të mbledhë të dhënat personale;
- ✓ Të marrë pëlqimin konfirmues kur kërkohet nga ligji në fuqi;
- ✓ Të mbledhë, përpunojë, përdorë dhe ruajë të dhënat personale vetëm për qëllimet që na janë dhënë, përveç rasteve kur kemi një bazë tjetër të ligjshme për përdorime të tjera dhe kur është e nevojshme për qëllime arkivimi;
- ✓ Të marrë hapat e arsyeshëm për të ruajtur të dhënat personale, për të parandaluar nxjerrjen e tyre apo përdorimet e paautorizuara; dhe
- ✓ Të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse të privatësisë.

Ligjet në lidhje me privatësinë e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave zhvillohen

dhe ndryshohen vazhdimisht. Ne jemi të përkushtuar ndaj monitorimit të ligjeve evoluese të privatësisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, dhe, herë pas here, mund të përpilojmë politika specifike në lidhje me to.

Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar udhëzimeve të kompanisë mbi **mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e të dhënave**, që mund të gjenden në Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit.

## **Ne veprojmë në përputhje me ligjet e ruajtjes së dokumentacionit**

Shumë ligje në botë kërkojnë që Colgate të mbajë disa dokumentacione (përfshirë dokumentacionin fizik dhe të dhënat elektronike) për periudha të caktuara kohore. Mospajtueshmëria me këto kërkesa mund ta vërë kompaninë përballë gjobave të larta dhe dënimeve të tjera. Colgate është e përkushtuar ndaj Programit të Menaxhimit të Dokumentacionit, i cili përmbush të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore përkatëse, plotëson nevojat e biznesit tonë për mbajtjen e informacionit dhe udhëzon që dokumentacioni i vjetër dhe i panevojshëm dhe dokumentet e tjera të eliminohen në mënyrën e duhur.

Jeni të detyruar të zbuloni informacionin përkatës dhe të nevojshëm ose dokumentet në një veprim ligjor, inspektim ose procedim, siç kërkohet me ligj. Me marrjen e ndonjë thirrjeje për paraqitje në gjyq, urdhri gjykate ose procesi tjetër ligjor që kërkon zbulimin e informacionit ose dokumenteve të kompanisë, ju kërkohet që të njoftoni Organizatën Ligjore Globale

(Global Legal Organization) deri në masën që e lejon ligji.

Në këtë rast, duhet të ndiqni të gjitha udhëzimet e dhëna nga Organizata Ligjore Globale (Global Legal Organization) dhe të ruani të gjithë dokumentacionin që mund t'i përgjigjet ose t'i përkasë thirrjes për paraqitje në gjyq, procesit gjyqësor ose hetimit, pavarësisht kërkesave të programit të ruajtjes së dokumentacionit. Nuk duhet ta zhdukni ose ndryshoni këtë dokumentacion, sepse zhdukja e pavend e dokumentacionit mund të ketë pasoja serioze, duke përfshirë dënime civile dhe/ose penale dhe pasoja punësimi, si për ju dhe për kompaninë.

Në qoftë se keni pyetje nëse një dokument ka të bëjë me një hetim, çështje gjyqësore ose thirrje në gjyq, kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization) përpara se ta asgjësoni dokumentin në fjalë. Punonjësit e Colgate mund të marrin informacion shtesë duke iu referuar “Politikës globale të programit të menaxhimit të dokumentacionit”.

## **Ne nuk japim kontribute politike**

Asnjë fond ose aktiv i kompanisë nuk mund të përdoret për kontribute për ndonjë parti politike ose kandidat në asnjë shtet dhe në asnjë nivel qeveritar. Kontributi politik përfshin si kontributin monetar, ashtu edhe atë jomonetar. Kontributet jomonetare përfshijnë blerjen e biletave për grumbullim fondesh, dhurimin e produkteve, punën vullnetare nga njerëzit e Colgate brenda orarit të

zakonshëm të punës dhe përdorimin e ambienteve të Colgate për synime politike ose të grumbullimit të fondeve. Në qoftë se keni ndonjë pyetje për kontributet e synuara politike, ju lutemi kontaktoni Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

Kompanisë nuk i lejohet që të kompensojë ose rimbursojë ndonjë person të Colgate ose individ të lidhur me kompaninë (duke përfshirë dhe lobistët e jashtëm ose palë të treta të tjera), në mënyrë direkte ose indirekte, në çfarëdolloj forme, për kontributet politike.


Punonjësit e Colgate, si individë, janë të lirë t'u japin kontribute personale kandidatëve ose partive që kanë zgjedhur vetë. Kontributi personal është përgjegjësi e individit dhe nuk duhet të kryhet kurrë me synimin që të ndihmojë në ndonjë mënyrë Colgate ose një prej kompanive të saj me të cilat punon.

Përveç kësaj, individët janë të lirë të përfshihen në veprimtari politike lokale

ose të kandidojnë për poste, por duhet të jetë e qartë se ata nuk përfaqësojnë në asnjë mënyrë kompaninë dhe veprimtaritë politike personale duhet të jenë të ndara nga puna e tyre për Colgate. Gjithashtu, asnjë veprimtari politike nuk mund të kryhet gjatë orarit të punës së kompanisë.

Ashtu si shumica e kompanive shumëkombëshe, Colgate bën pjesë dhe paguan kuota në një numër shoqatash tregtare dhe të industrisë. Për t'u siguruar që këto shoqata tregtare të mos përdorin asnjë pjesë të pagesave të Colgate për kontribute politike, Shefi i Colgate për Etikën dhe Pajtueshmërinë i dërgon një kujtesë vjetore të politikës sonë të gjitha shoqatave tregtare në SHBA, në të cilat Colgate është anëtare me pagesë dhe u kërkon të gjitha shoqatave tregtare që marrin një shumë të kufizuar të fondeve të Colgate për të marrë pjesë në një proces të përvitshëm certifikimi.

Për të mësuar më shumë ju lutemi referojuni **Politikës së Kontributeve Politike**, që mund të gjendet në seksionin e "Qeverisjes" në [colgatepalmolive.com](http://colgatepalmolive.com).



***Marrëdhënia  
me  
shoqërinë***

Ne kemi një rol jetik dhe përgjegjësinë për të kontribuar dhe për të vepruar në interesin më të mirë të komuniteteve në të cilat banojmë dhe punojmë.



## **Ne marrim pjesë në donacione dhe vullnetarizëm lokal**

Qëllimi ynë në të gjithë botën e Colgate është të marrim pjesë në projekte që e zhvillojnë më tej qëllimin tonë për të rikonceptuar një të ardhme më të shëndetshme për të gjithë njerëzit, kafshët e tyre shtëpiake dhe planetin tonë - duke përfshirë zhvillimin dhe mirëqenien e komuniteteve lokale.

Ne jemi të përkushtuar të garantojmë mirëqenien e atyre të cilëve u shërbejmë, të ndërtojmë një kulturë gjithëpërfshirjeje dhe të krijojmë mundësi kuptimplota që të gjithë punonjësit të ndihen të realizuar brenda dhe jashtë Colgate – dhe bashkëpunojmë me organizata jofitimprurëse që pasqyrojnë qëllimin e Colgate dhe përçojnë vlerat e Colgate:

- 1) Mbështetja e buzëqeshjeve të shëndetshme dhe lëkurës së shëndetshme;
- 2) Krijimi i mënyrave të edukimit për nxënës të ndryshëm dhe të nënpërfaqësuar dhe për profesionet e Colgate (stomatologjia, dermatologjia dhe kujdesi për lëkurën, shkencat veterinare);
- 3) Ofrimi i ushqimit, strehimit, dashurisë për kafshët shtëpiake kudo;
- 4) Promovimi i kujdesit për ambientin;
- 5) Mbështetja e optimizmit; dhe
- 6) Ofrimi i ndihmës në rast fatkeqësish natyrore dhe i kujdesit emergjent në komunitetet e Colgate.

Kompania sponsorizon programe leximi, iniciativa trajnimi, programe bursash, konkurse atletike dhe veprimtari të tjera në mbarë botën. Kompania gjithashtu i inkurajon punonjësit tanë që, gjatë kohës së tyre të lirë, të marrin pjesë në aktivitete humanitare lokale që ndihmojnë në përmbushjen e qëllimit tonë.



## **Ne punojmë me qeveritë për çështje që ndikojnë në biznesin tonë**

Kompania jonë kryen biznes në mbi 200 shtete dhe territore. Është politikë e jona që të bashkëpunojmë me qeveritë kombëtare dhe lokale. Herë pas here, mund të lindin çështje që prekin operacionet tona. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm, kompania mund t'u ofrojë mendime dhe rekomandime qeverive në lidhje me çështje të caktuara për mbështetjen e synimeve dhe nevojave të biznesit tonë. Megjithatë, kjo nuk duhet të ndodhë kurrë pa u konsultuar më parë me menaxherin tuaj dhe Organizatën Ligjore Globale (Global Legal Organization).

## **Ne kundërshtojmë praktikat e punës shfrytëzuese çnjerëzore**

Colgate është kundër përdorimit të paligjshëm të punës së fëmijëve, shfrytëzimin e personave dhe të gjitha formave të tjera të trajtimit të papranueshëm të punëtorëve.

Për më tepër, është politikë e Colgate që të mos punojë me asnjë furnitor apo kontraktor që njihet për përdorimin e

praktikave çnjerezore të punës, që përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

- Shfrytëzimi
- Ndëshkimi fizik
- Abuzimi
- Puna në burg, puna e detyruar dhe/ose skllavërimi
- Robëria e pavullnetshme
- Çdo formë e trafikimit të qenieve njerëzore ose
- Forma të tjera të keqtrajtimit

Colgate nuk e lejon shkeljen e ligjeve të punës dhe nëse kompania mëson për ndonjë shkelje, kjo mund të përbëjë bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së biznesit.


## **Ne demonstrojmë përkushtimin tonë ndaj të drejtave universale të njeriut**

Colgate ka një angazhim të vjetër në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë në mbarë botën dhe mbështet Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut, dhe është një anëtar themelues i Parimeve Globale të Sullivanit. Colgate gjithashtu është zotuar tek Rezoluta e Forumeve të Mallrave të Konsumit mbi Punën e Detyruar dhe ka zbatuar Parimet Bazë të Industrisë së saj. Duke marrë parasysh këto zotime, Colgate vë në praktikë dhe kërkon të punojë me partnerë në biznes që promovojnë standardet si vijon:

- ✓ Shanse të barabarta për të gjithë punonjësit në të gjitha nivelet pavarësisht nga raca, ngjyra, feja, gjinia, identiteti gjinor, origjina kombëtare, nënshtetësia,

etnia, mosha, orientimi seksual, aftësitë e kufizuara, statusi martesor apo familjar, statusi i veteranit apo ndonjë tipar tjetër i mbrojtur nga ligji;

- ✓ Një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm që nxit mirëqenien dhe mbron mjedisin;
- ✓ Rroga që përputhen me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatuara;
- ✓ Përmbushja e orëve të punës sipas ligjit dhe kompensimi për punën jashtë orarit bazuar në ligjet lokale;
- ✓ Respekt për lirinë e organizimit të ligjshëm të punonjësve dhe njohjen e të gjitha të drejtave ligjore për t'u organizuar dhe për të kërkuar marrëveshje në mënyrë kolektive;
- ✓ Një proces rekrutimi, marrje në punë dhe punësimi që nuk i kërkon punëtorëve të paguajnë ndonjë tarifë apo depozitë (monetare ose të tjera), duke përfshirë pagesën për ndonjë agjenci, rekrutues apo agjent ndërmjetësimi;
- ✓ Një proces rekrutimi, marrje në punë dhe punësimi që, përveç rasteve kur kërkohet nga ligji, nuk i kërkon punonjësve të dorëzojnë dokumentet origjinale të identifikimit, dokumentet e udhëtimit apo ndonjë dokument tjetër personal apo sende me vlerë, apo dokumente të tjera që do të kufizonin lirinë e tyre për të lëvizur;
- ✓ Punësim i bazuar në miratimin e lirë dhe të informuar të punonjësit për të hyrë dhe për të përfunduar marrëdhënien e punës; dhe
- ✓ Pagesën e rrogave, përgjatë marrëdhënies së punësimit dhe pas përfundimit të punësimit, bazuar në kushtet e kontratës apo sipas kërkesave të ligjit.



# *Marrëdhënia me mjedisin*

Ne jemi të përkushtuar që të veprojmë në mënyrë të përgjegjshme dhe të bëjmë pjesën që na takon për të ndihmuar në ruajtjen e burimeve të shterueshme të tokës dhe ruajtjen e mirëqenies së planetit tonë.

## **Ne jemi të përkushtuar ndaj ruajtjes së burimeve dhe ndaj përgjegjësisë sociale**

Te Colgate, ne i japim të njëjtën rëndësi të madhe ruajtjes së burimeve, të cilën e zbatojmë në çdo aspekt të biznesit tonë. Colgate ka mbështetur gjithmonë parimet e ruajtjes së burimeve dhe vlerat tona thelbësore-kujdesi, puna globale si ekip dhe përmirësimi i vazhdueshëm, udhëheqin përpjekjet tona për ruajtjen e burimeve. Ne i fokusojmë ambiciet tona në nxitjen e ndikimit në shoqëri, në ndihmën ndaj miliona njerëzve nëpër shtëpi dhe në ruajtjen e mjedisit.

Përveç kësaj, ne jemi të përkushtuar të arrijmë objektivin tonë të ruajtjes së burimeve globale për të siguruar rritjen e vazhdueshme dhe të përgjegjshme të biznesit të Colgate, në përfitim të të gjitha palëve të interesuara që u shërbejmë, duke përfshirë punonjësit tanë, aksionarët tanë, konsumatorët tanë, klientët tanë, partnerët e jashtëm dhe palë të tjera të interesuara në mbarë botën, ndërkohë që nxisim mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Gjatë viteve të fundit, përkushtimi ynë ndaj ruajtjes së burimeve dhe përgjegjësisë sociale është rritur me integrimin e këtyre ambicieve në operacionet e biznesit tonë dhe në planin tonë strategjik të rritjes. Kjo metodë integrimi ka forcuar ndikimin tonë për ruajtjen e burimeve, përgjegjësinë sociale dhe ecurinë e biznesit tonë, duke na ndihmuar që të rekrutojmë dhe mbajmë talentet më të mira, duke përmirësuar marrëdhëniet tona me palë

të tjera të interesuara dhe duke ofruar mundësi të reja për novacion. Ndoshta më i rëndësishëm është fakti që ky përkushtim ka entuziazmuar dhe angazhuar njerëzit e Colgate kudo në botë.


Për informacion shtesë lidhur me programin për ruajtjen e burimeve dhe iniciativat e kompanisë, vizitoni [colgatepalmolive.com](http://colgatepalmolive.com) për të shqyrtuar **raportin tonë për ruajtjen e burimeve** ku ne përvijojmë mënyrën se si e përmbushim qëllimin tonë për të konceptuar një të ardhme më të shëndetshme për të gjithë njerëzit, kafshët e tyre shtëpiake dhe planetin tonë.

## **Ne e ruajmë dhe mbrojmë planetin**

Kompania është e përkushtuar që të bëjë atë që i takon dhe të ndihmojë në ruajtjen dhe konservimin e burimeve të shterueshme të tokës. Angazhimet tona të lidhura me planetin përfshijnë përdorimin e energjisë, emetimet e karbonit, përdorimin e ujit dhe riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve. Prandaj secili prej nesh duhet të veprojë në përputhje të plotë me formën dhe përmbajtjen e ligjeve dhe rregullave përkatëse për mjedisin dhe politikën publike që përfaqësojnë.

Ne nxisim komunikimet e hapura me publikun dhe mbajmë një partneritet aktiv dhe produktiv me komunitetet ku operojmë. Ne do të vazhdojmë t'u japim informacion konsumatorëve në lidhje me programet dhe strategjinë tonë për mjedisin dhe do të punojmë me udhëheqës të komunitetit dhe të gjithë ata që kanë të njëjtin përkushtim me ne.

Strategjia jonë e vazhdueshme për të ulur ndotjen e mjedisit do të mbetet një pjesë përbërëse e prodhimit, ambalazhimit, shpërndarjes dhe marketingut të produkteve tona.



***Marrëdhënia  
me  
aksionarët  
e tjerë***

Ne përpiqemi t'u shërbejmë interesave më të mira të aksionarëve tanë dhe jemi të vendosur ta rrisim vlerën e aksionarëve duke krijuar produkte novatore që janë në përfitim të njerëzve, kafshëve të tyre shtëpiake dhe planetit tonë.

## **Ne përkrahim qeverisjen e mirë të korporatës**

Programet dhe politikat e kompanisë për qeverisjen korporative, pjesë e rëndësishme e të cilave është edhe ky Kod Sjelljeje, shërbejnë si një mbrojtje e rëndësishme e aksionarëve. Në vitet e fundit janë kryer shumë kontrolle nga Kongresi, Komisioni Amerikan i Letrave me Vlerë dhe Shkëmbimeve, Bursa e Nju-Jorkut, dhe nga të tjera institucione në mbarë botën në mënyrë që të reklamojmë sjelljen etike të korporatës që ka qenë një praktikë standarde në Colgate për shumë vite. Aksionarët tanë shërbehen mirë nga një bord i pavarur, i përbërë nga një shumicë e konsiderueshme drejtorësh të pavarur dhe komitetesh të pavarur që mbikëqyrin çështje të revizionimit, kompensimit dhe qeverisjes. Statutet e komiteteve dhe udhëzimet qeverisëse që përditësohen vazhdimisht përcaktojnë me qartësi përgjegjësitë dhe rolet e drejtorëve dhe parimet e kompanisë për qeverisjen korporative.

Për informacione të mëtejshme lidhur me programin e qeverisjes së korporatës të kompanisë, ju lutemi shihni Udhëzuesin e Bordit mbi Çështjet e Rëndësishme të Qeverisjes Korporative dhe statutet e Komisionit të Revizionimit të Kompanisë, Komisionit të Emërimeve, Qeverisjes dhe Përgjegjësisë Korporative, Komisionit të Personelit dhe Organizatës dhe Komisionit të Financës.


## **Ne kemi programe të fuqishme revizionimi për rritjen e besimit të investitorëve**

Kompania është e përkushtuar ndaj cilësisë, ndershmërisë dhe transparencës së raporteve të saj financiare. Ky përkushtim reflektohet në procedurat dhe politikat e përhershme të kompanisë, duke përfshirë një grup të brendshëm revizionimi që monitoron kontrollet financiare mbarëbotërore, revizorë të pavarur që kanë një mandat të gjerë dhe Komisionin e Pavarur të Revizionimit që mbikëqyr këto fusha. Për të maksimalizuar efektshmërinë e këtyre burimeve, prej njerëzve të Colgate pritet që të përfshihen në komunikime të hapura e të sqarta dhe shkëmbim të lirë të informacionit me revizorët e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me Komisionin e Revizionimit.

Për informacione shtesë lidhur me rolet e rëndësishme të revizionuesve të brendshëm të Kompanisë, revizionuesve të pavarur dhe Komisionit të Revizionimit, ju lutemi shihni **Dokumentet e Komisionit të Revizionimit**.

## **Ne i mbajmë të informuar aksionarët tanë për përparimin e kompanisë**

Çdo vit aksionarët ftohen që të marrin pjesë në mbledhjen vjetore të kompanisë ku rishikohet përparimi i kompanisë gjatë vitit të mëparshëm dhe aksionarët kanë mundësinë t'u bëjnë pyetje drejtuesve të lartë të kompanisë. Në muajt ndërmjetës, aksionarët mund të vizitojnë seksionin e **Qendrës së Investitorëve** në faqen e internetit të Kompanisë.



***Përgjegjësia  
jonë për të  
shprehur hapur  
mendimin***

Ne ruajmë standardet më të larta etike nëpërmjet fjalëve dhe veprimeve tona dhe sfidojmë sjelljen e të tjerëve kur bie ndesh me Kodin tonë të Sjelljes, Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit dhe politikat e kompanisë.

## ***Komunikimi i qartë është i domosdoshëm***

Secili prej nesh është përgjegjës për të zbatuar standardet e kompanisë për sjelljen etike, bazuar në të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe bazuar në udhëzimet që përmban Udhëzuesi i Praktikave të Biznesit, si edhe politika, procedura dhe udhëzues të tjerë të kompanisë.

Menaxherët kanë përgjegjësinë që t'ua komunikojnë këto standarde punonjësve të Colgate me të cilët ata punojnë, duke siguruar që të krijojnë një klimë ku njerëzit

të mund të diskutojnë lirshëm çështjet etike dhe ligjore.

## ***Ne kemi burime të brendshme që mund t'ju asistojnë në rast se keni nevojë për udhëzime apo mbështetje***

Kodi nuk mund t'u japë përgjigje përfundimtare të gjitha pyetjeve. Për këtë ne duhet të mbështetemi përfundimisht në gjykimin e shëndoshë të secilit në lidhje me atë që kërkohet për të vepruar në përputhje me standardet e larta të kompanisë duke përfshirë gjykimin se kur është e përshtatshme për të kërkuar këshilla për rrugën e duhur të veprimit. Nëse keni pyetje apo jeni në dyshim për mënyrën më të mirë për të vepruar në një situatë të caktuar, ju lutemi kërkonit udhëzime sipas shpjegimit të mëposhtëm:

## ***Ku duhet të shkoj nëse më duhet ndihmë?***

### **Menaxheri Juaj**

Flisni me menaxherin tuaj apo me një anëtar të ekipit udhëheqës të organizatës për të diskutuar shqetësimet ose në rast se keni pyetje.

### **Burimet Njerëzore (Human Resources)**

Përfaqësuesi juaj lokal i Zyrës së Burimeve Njerëzore (Human Resources) është një tjetër burim i vlefshëm për t'u këshilluar dhe konsultuar.

### **Departamenti Ligjor**

Kontakttoni një anëtar të Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization) për çdo pyetje pajtueshmërie apo për të marrë këshillim/asistencë me interpretimin e ligjeve, rregulloreve apo politikave.

### **Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë (Ethics & Compliance)**

Kontakttoni Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë (Ethics & Compliance) për të bërë pyetje, për të marrë udhëzime se si zbatohet Kodi në një situatë të caktuar apo për të "shprehur hapur mendimin" në rast të një sjelljeje potencialisht të pahijshme.

## Duhet kurajë për të shprehur hapur mendimin

Në qoftë se jeni në dijeni ose keni një arsye të fortë që të dyshoni për një shkelje të Kodit, Udhëzuesit të Praktikave të Biznesit ose politikave të tjera të kompanisë, ju kërkohet t'ia raportoni menjëherë këtë

informacion menaxherit tuaj, Zyrës së Burimeve Njerëzore (Human Resources), Departamentit të Etikës dhe Pajtushmërisë Globale (Global Ethics and Compliance) ose Organizatës Ligjore Globale (Global Legal Organization). Si alternativë, mos ngurroni t'u drejtoheni niveleve më të larta të menaxhimit pa pasur frikë për hakmarrje ndaj jush.

### POSTA ELEKTRONIKE

ethics@colpal.com

### MJETET E INTERNETIT

<https://colpal.ethicspoint.com/>

### POSTA ZANORE

(800) 778-6080  
(falas nga SHBA, Kanadaja dhe Porto Riko) +1 (212) 310-2330 (nga të gjitha vendet e tjera)

### POSTA

Global Ethics & Compliance  
Colgate-Palmolive Company  
300 Park Ave,  
New York, NY 10022

### APLIKACIONI CELULAR

I disponueshëm për t'u shkarkuar nga Dyqani i Aplikacioneve CP

### Kodi QR



## Si mund të sigurohem që nuk do të merret asnjë masë negative kundër meje?

### Politika kundër hakmarrjes

Është politika dhe praktika e Colgate të ruajë norma etike sa më të larta dhe të krijojë një mjedis pune pa sjellje të papërshtatshme ose të paligjshme, ku njerëzit inkurajohen të ndajnë shqetësimet e tyre me kompaninë, pa pasur frikën e hakmarrjes ndaj tyre. Si rrjedhojë, në Colgate, asnjë veprim i padëshirueshëm nuk do të ndërmerret kundër ndonjë punonjësi, ish-punonjësi, agjenti ose pale të tretë, sepse është ankuar, ka raportuar, ka

marrë pjesë apo ka ndihmuar në hetimin e një shkeljeje të dyshuar të Kodit të Sjelljes të kompanisë, politikës së kompanisë ose ligjit përkatës, përveçse kur akuzat e bërë ose informacioni i dhënë zbulohet se është falsifikuar me qëllim ose nuk u bë me qëllim të mirë. Colgate do të ruajë konfidencialitetin e të gjitha ankesave në masën maksimale të mundshme. Të gjitha akuzat për hakmarrje do të hetohen dhe, nëse shihet me vend, do të ndërmerret veprim disiplinor deri në, dhe duke përfshirë, heqjen nga puna.

Rishikohet i gjithë informacioni që i jepet Departamentit të Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance), dhe nëse lidhet me Kodin, çështja hetohet me shpejtësi dhe në tërësi nga Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance) dhe/apo nga Organizata Ligjore Globale (Global Legal Organization). Është shumë e rëndësishme që personat që raportojnë të mos bëjnë hetimet e veta, sepse hetimet mund të përfshijnë çështje ligjore komplekse. Veprimi sipas mendjes tuaj mund të kompromentojë vërtetësinë e hetimit dhe të ketë pasoja të padëshirueshme, si për ju, ashtu dhe për Colgate.

Raportimet mund të kryhen në mënyrë anonime nëse e lejon ligji vendas. Por ne


do të marrë të gjitha masat e duhura për të ruajtur identitetin e individit dhe informacionin e dhënë si konfidencial dhe do ta zbulojë informacionin vetëm te personat që duhet ta dinë kur zbulimi:

- Është i nevojshëm për kryerjen e një hetimi efikas, marrjen e përgjigjeve ose marrjen e masave të nevojshme; ose
- Kërkohet ndryshe nga ligji në fuqi.

Raportimi ose ankesa mund të përmbajnë të dhëna personale. Për arsye të hetimit të një shkeljeje ose dyshimit për shkelje, në varësi të ligjit vendas, mund të jetë e nevojshme që të dhënat personale të grumbulluara në një vend të transferohen në vende të tjera, duke përfshirë Shtetet

## Procesi i hetimit i Departamentit të Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance)


Punonjësit e Colgate pritet të ofrojnë bashkëpunimin e tyre të plotë kur marrin pjesë në ndonjë hetim të kompanisë.



ju inkurajojmë që të identifikoheni kur telefononi për të ndihmuar në lehtësimin e hetimit dhe ndjekjes. Në disa vende ka ligje të cilat e kufizojnë llojin e informacionit që mund të raportoni. Në qoftë se këto ligje kanë të bëjnë me situatën tuaj, një përfaqësues nga Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance) do t'ju drejtojë te dikush në njësinë tuaj të biznesit, i cili mund t'ju ndihmojë me pyetjen ose shqetësimin tuaj. Megjithatë, mbani parasysh se nëse dëshironi të identifikoheni, kompania

e Bashkuara. Në raste të tilla, të dhënat personale mund të përdoren nga punonjës të kompanisë dhe subjekte të Colgate, të cilët marrin pjesë në operacionet e Departamentit të Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance) për hetimin e raportit, por vetëm për atë periudhë që është e nevojshme, në mënyrë të arsyeshme për këtë qëllim (dhe pas kësaj të dhëna të tilla personale do të zhduken ose ruhen vetëm sipas kërkesës së ligjit ose politikës së kompanisë).

## Çfarë ndodh kur punonjësit e Colgate “shprehin hapur mendimin” pranë Departamentit të Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance)



### **Shembuj të shqetësimeve të cilat përgjithësisht nuk duhen raportuar te Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics & Compliance):**

- ✓ Planet e Shpërblimit apo Pagesa e Shpërblimit
- ✓ Çështje të Pagave
- ✓ Koha e Lejes apo Pushimit
- ✓ Objektivat Individuale
- ✓ Plani i Punës apo Ndryshimi i Turneve
- ✓ Pjesëmarrja
- ✓ Përfitimet Mjekësore ose të Aftësisë së Kufizuar

Këto lloj shqetësimesh zakonisht i duhen sjellë në vëmendje Zyrës së Burimeve Njerëzore (Human Resources).

### **Mund të merren masa disiplinore**

Kompania ka “tolerancë zero” ndaj çfarëdolloj sjelljeje që shkel Kodin ose Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit.

Kjo do të thotë që kur verifikohet një shkelje, ndërmerret veprimi i duhur në përputhje me natyrën dhe masën e shkeljes.

### **Shembuj të veprimeve që mund të ishin ndërmarrë përfshijnë:**

- ✓ Përmirësimet në proces
- ✓ Zhvillimi apo rishikimi i politikave
- ✓ Strategjia e komunikimit
- ✓ Caktimi i një instruktori apo këshilltari
- ✓ Masat disiplinore
- ✓ Përfundimi i marrëdhënies së punës

Asnjë individ ose menaxher në kompani nuk ka autoritet që të përfshihet në veprime që nuk janë në përputhje me këtë Kod, ose të autorizojë, drejtojë, aprovojë ose nxisë një veprim të tillë nga ndonjë person tjetër.

Në këtë mënyrë, kompania ka si synim që të parandalojë dukuri të sjelljes që nuk përputhen me Kodin ose Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit dhe të ndalojë çfarëdolloj sjelljeje të tillë që mund të ndodhë, sa më shpejt që të jetë e mundur pas zbulimit të saj. Njerëzit e Colgate që shkelin Kodin ose Udhëzuesin e Praktikave të Biznesit mund t’u nënshtrohen akteve disiplinore deri dhe duke përfshirë heqjen nga puna sipas ligjeve lokale.

### **Kodi zbatohet për të gjithë punonjësit dhe për të gjitha veprimtaritë e Colgate**

Zbatimi i Kodit të Sjelljes dhe Udhëzuesit të Praktikave të Biznesit do të monitorohet nga Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance). Departamenti i raporton kryetarit, presidentit dhe drejtorit ekzekutiv dhe kryetarit të Komisionit të Revizionimit të Bordit të Drejtorëve të Colgate në lidhje me krijimin, vënien në jetë dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe programeve përkatëse. Informacioni që i raportohet Departamentit të Etikës dhe Pajtueshmërisë Globale (Global Ethics and Compliance Department) ose nëpërmjet kanaleve të tjera, sipas rastit, i komunikohet Komisionit të Revizionimit në mënyrë konfidenciale. Kodi zbatohet për të gjithë ata të cilët punojnë për Kompaninë Colgate-Palmolive dhe degët e tyre, duke përfshirë drejtuesit. Kopje të Kodit janë të disponueshme në internet si në rrjetin e brendshëm ashtu dhe në faqen tonë të jashtme të internetit. Punonjësit e Colgate kudo në botë demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj pajtueshmërisë dhe normave etike të kompanisë duke marrë pjesë çdo vit në trajnime dhe certifikimin për Kodin e Sjelljes.

## **Keni një pyetje? Na lejoni t'ju orientojmë në drejtimin e duhur.**



Cilat janë udhëzimet e kompanisë lidhur me dhënien ose marrjen e dhuratave?



Jam i shqetësuar për hakmarrjen. Cila është politika e kompanisë?




Cilat janë pritshmëritë e kompanisë lidhur me përdorimin e mediave sociale nga punonjësit e Colgate?



Si menaxher i punonjësve, si të demonstroj udhëheqje etike?



Cila është politika e kompanisë për ngacmimet?



Cilat janë opsionet në dispozicionin tim nëse më duhet të “shpreh hapur mendimin”?



A është mirë që unë të pranoj një punë të dytë jashtë Colgate?



Çfarë është informacioni i rezervuar?



300 Park Avenue  
New York, NY 10022  
212-310-2000  
[www.colgatepalmolive.com](http://www.colgatepalmolive.com)